

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7812  
E premte, 14 qershor 2024  
Çmimi 0.50 €

Reagim i KMDLNj-së

## Me çka të krenohemi për 25-vjetorin e çlirimit?!



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# BISLIMI THOTË SE RAPORTI I BORRELLIT PRITET TË REKOMANDOJË HEQJEN E MASAVE PËR KOSOVËN



Edhe pse nuk pa pasur një datë formale të martën e shkuar, më 11 qershor, vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) duhej t'u dorëzohej raporti i përfaqësuesit të lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe

siguri, Josep Borrell, rreth përbushjes së kushteve nga ana e Kosovës për heqjen e masave të BE-së ndaj saj. Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Besnik Bislimi, ka thënë të enjten se ky

raport, përmbajtja e të cilit ende nuk dihet, pritet të dorëzohet gjatë javës së ardhshme. "Përmbajtja e raportit mesa e di unë është pozitive dhe aty do të rekomandohet heqja e masave", ka theksuar Bislimi

## KOSOVA VENDOS SANKSIONE KUNDËR RUSISË, BJELLORUSISË DHE IRANIT



## NJË HAP DREJT PAQES NË UKRAINË

Josep BORRELL, përfaqësues i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri



### AKTUALE

PSE ËSHTË PROBLEMATIKE DEKLARATA E "KUVENDIT GJITHËSERB"? F. 4

KUSARI: LV-ja KA INJORUAR 83 PËR QIND TË REKOMANDIMEVE TË KIE-së PËR PROJEKTLIGJIN PËR KPM-në F. 7

KOSOVA BËHET ANËTARE E KOALICIONIT TË DEMINIMIT PËR UKRAINËN F. 3

### EKONOMI

KURTI: KRAHASUAR ME KATËR VITET MË PARË, SIVJET E KEMI 50% MË TË LARTË BRUTO PRODUKTIN VENDOR F. 8

QEVERIA E KOSOVËS NDAN 3 MILIONË EURO PËR MBULIM POLICËS KUFITARE PËR MËRGIMTARËT F. 8

### SPORT



Intervistë me Presidentin e FC Kosova Düsseldorf, BUJAR NEZIRIN

NEZIRI: FC KOSOVA DÜSSELDORF SYNON NGRITJEN NË OBERLIGA F. 10



SONTE FILLON 'EURO 2024', NESËR SHQIPËRIA PËRBALLET ME ITALINË

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## NATO-ja thotë se mbi 300 mijë trupa janë në gatishmëri të lartë



**BRUKSEL, 13 QERSHOR** - Vendet e NATO-s e kanë "tejkualuar me lehtësi" objektivin e vendosjes së 300.000 trupave në gatishmëri të lartë derisa aleanca përballet me kërcënimin nga Rusia, tha të enjten një zyrtar i lartë i aleancës.

Udhëheqësit e NATO-s u pajtuan në vazhden e pushtimit të Ukrainës nga Moska që ka nisur në vitin 2022, për të rritur masivisht numrin e forcave që komandantët e aleancës mund të vendosin brenda 30 ditësh. "Ofertat në tryezë nga aleatët tejkalojnë 300.000 që kemi vendosur", tha zyrtari në kushte anonimiteti. "Këto janë forca që aleatët na kanë thënë: Ata janë në dispozicion për ju që tani në atë nivel gatishmërie", shtoi ai. Shtytja për të pasur më shumë trupa në gatishmëri për t'u përgjigjur shpejt, është pjesë e

një rishikimi më të gjerë të planeve të NATO-s për të shmangur çdo sulm të mundshëm rus, që u nënshkrua në një samit vitin e kaluar.

Këto plane paraqiten për herë të parë që nga fundi i Luftës së Ftohtë se çfarë do të pritej të bënte secili anëtar i aleancës së udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara, në rast të një pushtimi nga Moska.

Komandantët e NATO-s aktualisht po përpiqen të sigurohen që kanë aftësitë për të ekzekutuar ato plane nëse është e nevojshme.

Por aleanca përballet me mangësi në armatimet kryesore, si mbrojtja ajrore dhe raketat me rreze më të gjatë. "Ka gjëra që ne nuk na mjaftojnë si aleancë për momentin dhe duhet t'i trajtojmë", tha ky zyrtar, raporton Rel.

## Argjentina tronditet nga përleshjet për shkak të projektligjit për reforma

**BUENOS AIRES, 13 QERSHOR**- Senati i Argjentinës e kaloi të mërkurën vonë një projektligj të presidentit Javier Milei për reforma ekonomike, duke nxitur protesta dhe përleshje mes demonstruesve dhe policisë në rrugët e Buenos Aires.

Dhoma e lartë e Senatit ishte e ndarë gjatë votimit të projektligjit, por e kaloi atë përfundimisht me 37 vota për dhe 36 kundër, falë votës së kryetares së dhomës, zëvendëspresidentes Victoria Villarruel.

Votimit i parapriu një debat maratonik dhe senatorët tani duhet të votojnë për secilin nen të projektligjit një nga një, i cili synon t'i rritë investimet duke i privatizuar subjektet shtetërore

dhe duke stimuluar bizneset.

Protestuesit hodhën gurë dhe dogjën vetura me koktej molotovi, ndërsa policia iu përgjigj duke përdorur gaz lotsjellës dhe topa uji.

Reformat përfshijnë ringjalljen e ekonomisë së vendit, shpalljen e një emergjence shtetërore ekonomike, uljen e pensioneve dhe dobësimin e të drejtave të punëtorëve.

Projektligji kishte kaluar në dhomën e ulët në prill, por duhet të kthehet në votim pas ndryshimeve në Senat. "Sot, i kemi dy Argjentina", tha Villarruel, teksa votoi në favor të reformave. "Një Argjentinë e dhunshme që ia vë zjarrin automjetit, hedh gurë dhe debaton për ushtrimin e



demokracisë, dhe një Argjentinë tjetër me punëtorë, të cilët e presin me vuajtje dhe sakrificë ndryshimin për të cilin votuan", tha ajo.

Qeveria e Mileit nuk e gëzon shumicën në asnjërën prej

dhomave të Senatit.

Ky projektligj është çelësi për planet e Mileit për ta ndryshuar ekonominë e rrënuar të vendit, ku inflacioni ka arritur gati 300 për qind, dhe përfshin plane për t'i privatizuar ndërmarrjet

publike, për t'i dhënë pushtet të veçantë presidentit dhe për të nxitur investime.

Por, disa protestues druanë se projektligji rrezikon ta rrisë papunësinë dhe çmimet e produkteve ushqimore. "Po luhet me jetën e qytetarëve argjentinës. Ne e kemi pirë këtë helm shumë herë: të kemi zero inflacion me zero aktivitete ekonomike", tha lideri social dhe i protestave, Luis D'Elia, teksa mijëra njerëz protestuan kundër reformave.

Zyra e Mileit e festoi kalimin e projektligjit. "Çfarë ndodhi sonë është triumf për popullin argjentinës dhe hapi i parë drejt kthimit të madhështisë sonë", tha Zyra e presidentit në një komunikatë.

## Liderët e G7-s pajtohen t'i japin Ukrainës miliarda dollarë hua duke përdorur asetet e ngrira ruse

**UASHINGTON, 13 QERSHOR**- Liderët e shtatë vendeve më të industrializuara në botë (G7) u pajtuan të enjten t'ia japin Ukrainës 50 miliardë dollarë hua duke i përdorur asetet e ngrira ruse.

Diplomatët konfirmuan se pajtueshmëria për këtë marrëveshje u arrit madje para se liderët të mbërrinin në Itali për samitin tregëtor të G7-s.

Hollësitë e marrëveshjes do të diskutohen gjatë takimit të tyre në Itali, por Kievi pritet t'i marrë paratë kah fundi i këtij viti.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr



Zelensky, do të jetë në Itali gjithashtu dhe pritet të nënshkruajë një marrëveshje tjetër dypalëshe për sigurinë me presidentin e Shteteve të Bashkuara, Joe Biden.

Vendet e G7-ës, Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara, ngrinë asete ruse në vlerë prej rreth 300 miliardë dollarësh, pak pasi Moska nisi pushtimin e fqinjit të saj në shkurt të vitit 2022.

Në fillim të kësaj jave, Zelensky tha se pret që t'i sigurojë miliarda euro nga vendet aleate për

mbrojtjen e Ukrainës dhe për rindërtimin e vendit të vet pas luftës.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022.

Presidenti rus, Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për të çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



# Bislimi thotë se raporti i Borrellit pritet të rekomandojë heqjen e masave për Kosovën

Edhe pse nuk pa pasur një datë formale të martën e shkuar, më 11 qershor, vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) duhej t'u dorëzohej raporti i përfaqësuesit të lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, rreth përmbushjes së kushteve nga ana e Kosovës për heqjen e masave të BE-së ndaj saj. Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Besnik Bislimi, ka thënë të enjten se ky raport, përmbajtja e të cilit ende nuk dihet, pritet të dorëzohet gjatë javës së ardhshme. "Përmbajtja e raportit mesa e di unë është pozitive dhe aty do të rekomandohet heqja e masave", ka theksuar Bislimi

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 13 QERSHOR** - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka raportuar të enjten në Komisionin për Integrim Evropian, mbi procesin e integritimit evropian.

Në adresimin e tij hyrës, ai raportoi mbi nivelin e zbatimit të Agjendës për Reforma Evropiane ERA II dhe zbatimin e Programit Kombëtar për Integrim Evropian në vitin e kaluar. "Plani i Veprimit të ERA II ka përfshirë 15 prioritetet dhe 341 reforma konkrete apo tregues. Sipas gjetjeve të raportit përfundimtar mbi të arriturat në zbatimin e ERA II, deri në fund të vitit që lamë pas janë zbatuar 245 nga gjithsej 341 tregues, ose 72%", u shpreh zëvendëskryeministri mbi nivelin e zbatimit të ERA II.

Kjo përbën një rritje të konsiderueshme nga niveli i zbatimit të ERA I, i cili ka qenë në nivelin 45%. "Tashmë që të dy dokumentet e Agjendës për Reforma Evropiane kanë përfunduar zbatimin, pra ERA I dhe II, mund të krahasojmë trendin e realizimit të reformave. Për dijeninë tuaj, ERA I ishte zbatuar në periudhën Nëntor 2016 – Dhjetor 2019. Zbatimi i saj ka qenë 45%, ndërsa niveli i realizimit të ERA II qëndron tek 72%. Kjo rritje në nivelin e realizimit shpalos një rritje të konsiderueshme në realizimin e reformave të integritimit evropian si dhe një rritje në tempon e realizimit të reformave. Kështu Republika e Kosovës çdo ditë e më shumë po dëshmon se është gati të avancojë në integrimin evropian duke arritur kështu gradualisht përafërim të plotë me standardet e BE-së. Rritja e



realizimit të reformave është një lajm dhe arritje e mrekullueshme për qytetarët e Kosovës", shtoi zëvendëskryeministri Bislimi. Në vijim, në lidhje me Programin Kombëtar për Integrim Evropian, zëvendëskryeministri theksoi se deri në fund të vitit të kaluar qeveria kishte miratuar 13 projektligje dhe i ka përcjell ato në Kuvend për miratim, teksa radhiti dhe disa prej masave të rëndësishme të zbatuara. Bislimi ka thënë se raporti i shefit të Bashkimit Evropian për politikë të jashtme, Josep Borrell, për hapat që ka bërë Kosova në përmbushjen e detyrimeve për heqjen e masave të BE-së "do të

rekomandohet heqja e masave" ndëshkuese për Kosovën. Borrellit i ishte kërkuar një raport i tillë nga vendet anëtare në mënyrë që të vlerësohet nëse janë pjekur kushtet që Kosovës t'i hiqen masat ndëshkuese. Bislimi theksoi se raporti i Borrellit ka qenë "i gatshëm prej prillit, por ka pasur disa hezitime" për dorëzimin e tij. "Ka pasur hezitime të dërgohet [raporti] në komision, për shkak se, si duket, ka disa individë që kanë interes ta shtyjnë heqjen e masave ndaj Kosovës dhe si rezultat ta dëmtojnë Kosovën", tha ai, pa shpjeguar. Bislimi ka thënë se ky raport, përmbajtja e të cilit ende nuk

dihet, pritet të dorëzohet gjatë javës së ardhshme. "Raporti është dashur të dorëzohet pardje, mirëpo një pjesë e Komisionit kanë kërkuar të shtyhej dhe besoj që do të dorëzohet për aprovim në Këshill gjatë javës së ardhshme, përmbajtja e raportit mesa e di unë është pozitive dhe aty do të rekomandohet heqja e masave", theksoi Bislimi. Masat ndaj Kosovës ishin vendosur para një viti si përgjigje ndaj përshkallëzimit të situatës së sigurisë në veri të Kosovës, kur Kosova dërgoi në ndërtesat e komunave kryetarët shqiptarë të dalë nga zgjedhjet që u bojkotuan nga serbët.

## BE-ja: Serbia nuk mund të bëhet anëtare pa normalizimin e raporteve me Kosovën

Prishtinë, 13 qershor- Serbia nuk mund të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian pa normalizimin e raporteve të saj me Kosovën, tha për "Radion Evropa e Lirë" zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. "Marrëveshja e Ohrit aktualisht e bën këtë shumë të qartë: Nëse nuk ka progres në normalizim, nuk do të ketë progres në negociatat e anëtarësimit", shtoi ai.

Kjo deklaratë erdhi pasi ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, në një intervistë për edicionin e 13 qershorit të së përvajshmes NIN nga Beogradi, tha se njohja formale e Kosovës nuk do të jetë kusht për hyrjen e Serbisë në BE.

Bashkimi Evropian, megjithatë, nuk është shprehur qartë nëse njohja formale e Kosovës do të jetë kusht për Serbinë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, dhe Stano përsëriti se "qëndrimi i bllokut rreth kësaj çështjeje mbetet i pandryshuar". "Qëndrimi i BE-së rreth kësaj nuk ka ndryshuar dhe mbetet i njëjti, siç është thënë në të kaluarën dhe siç është cekur në kriteret e anëtarësimit", tha Stano. Prej se Kosova e shpalli pavarësinë, 15 vjet më parë, Bashkimi Evropian është shprehur vazhdimisht se çështja e njohjes së Kosovës është një



çështje në kompetencë të vendeve anëtare të BE-së dhe, si bllok evropian, ka mbajtur një qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës. Por, në anën tjetër, Kosova ka raporte të veçanta kontraktuale me Bashkimin Evropian, përmes Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit,

ndërsa në procesin e negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE nuk përfshihet territori i Kosovës. Në BE gjithmonë kanë ngulur këmbë që të përdorin normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Kosovën si kusht për Serbinë. Interpretimin se a nënkupton

"normalizimi i plotë" edhe njohjen formale të Kosovës nga Serbia, në BE ua kanë lënë palëve ta interpretojnë vetë. Një zyrtar i BE-së, duke rikujtuar edhe ndryshimet në kornizën e negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE, ku në kapitullin 35

është përfshirë si kusht edhe normalizimi i raporteve me Kosovën, ka thënë se pa këtë normalizim, Serbia nuk mund të bëhet anëtare e BE-së. Njëkohësisht, BE-ja ka thënë se lobimi i Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare përbën shkelje "të qartë" të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve fqinje. "Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit është e vlefshme dhe plotësisht detyruese për të dyja: Kosovën dhe Serbinë. Kjo përfshinë edhe Nenin 4. Lobimi i Serbisë kundër Kosovës është shkelje e qartë e kësaj marrëveshje", tha zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, për "Radion Evropa e Lirë". Nën ndërmjetësimin e BE-së, Kosova dhe Serbia më 2023 arritën Marrëveshjen drejt normalizimit të marrëdhënieve. Më vonë ajo u bë e njohur si Marrëveshja e Ohrit, por edhe kjo ka mbetur kryesisht e pazbatuar. Serbia loboi kundër anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës në maj, i cili përfundimisht vendosi të mos e fuste fare në agjendë kërkesën e Prishtinës për anëtarësim, pavarësisht se ajo i kaloi dy prej tri fazave të nevojshme.





# Pse është problematike Deklarata e 'Kuvendit gjithëserb'?

Një deklaratë që bëri thirrje për unitet të serbëve dhe për mbrojtje të interesave të tyre, e cila doli nga një tubim që mbledhi serbë nga i gjithë rajoni i Ballkanit në Beograd, i shqetësoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa mori përkrahjen e Rusisë. Por, çfarë thuhet në dokumentin e miratuar?

**PRISHTINË, 13 QERSHOR** - Një deklaratë që bëri thirrje për unitet të serbëve dhe për mbrojtje të interesave të tyre, e cila doli nga një tubim që mbledhi serbë nga i gjithë rajoni i Ballkanit në Beograd, i shqetësoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa mori përkrahjen e Rusisë. Por, çfarë thuhet në dokumentin e miratuar?

Thirrje për unitet të serbëve në rajon dhe për mbrojtje të interesave serbe, nën moton "Një popull, një kuvend - Serbia dhe Sërpska".

Këto i parashih një deklaratë e miratuar nga Serbia dhe nga entiteti serb i Bosnje e Hercegovinës, Republika Sërpska, më 8 qershor, në Beograd.

Në të ashtuquajturin "Kuvend gjithëserb" morën pjesë edhe pjesëtarë të Kishës Ortodokse Serbe dhe të partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, Lista Serbe, por edhe serbë tjerë të rajonit.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i shqetësoi ky organizim, i cili nga Rusia u përshëndet.

Diplomati Wolfgang Petritsch, ish-përfaqësues i lartë ndërkombëtar në Bosnje e Hercegovinë, i tha Radios Evropa e Lirë se serbët duhet të jenë të bashkuar vetëm nën ombrellën e Bashkimit Evropian. "Historia është shumë e rëndësishme për ne, evropianët. Kur Gjermania naziste e krijoi një

parlament gjithëgjerman, një lëvizje gjithëgjermane, përfunduam me Luftë të Dytë Botërore. Nuk dua që kjo të ndodhë me serbët", u shpreh ai. Megjithatë, shumë serbë nuk mendojnë njëjtë.

Branko Radivojeviq, banor i Banjallukës, shkoi në Beograd, më 8 qershor, për të mbështetur idenë e unitetit. "Ata [serbët] duhet të jetojnë në një shtet", tha ai. Cveta Radulloviq, banore e Beogradit, iu bashkua turmës për të përjetuar sërish "energjinë kombëtare" që ajo tha se besonte që "ka humbur".

Për të hyrë në fuqi, Deklarata e "Kuvendit gjithëserb" do të duhet të ratifikohet në Parlamentin e Serbisë dhe atë të Republikës Sërpska brenda 90 ditëve.

## Çfarë thuhet në deklaratë?

Dokumenti përbëhet prej 49 pikash. Aty thuhet që populli serb përbën një entitet të vetëm dhe që ndonëse "përgjatë historisë, populli serb ka jetuar në shumë shtete me emra të ndryshëm, ai ka të drejtë të ruajë traditën e tij të pasur".

Disa besojnë që nëse ai zbatohet në përpikëri, bashkëpunimi ndërmjet të dyja palëve do të jetë shumë më i madh, dhe se Serbia do ta risë

ndikimin në Republikën Sërpska, rrjedhimisht në Bosnje.

Deklarata e përbashkët u miratua në kohën kur presidenti i Republikës Sërpska, Millorad Dodik - i sanksionuar nga ShBA-ja përmend mundësinë e shkëputjes prej Bosnjës.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se dokumenti u përpilua në përputhje me rezolutat, me të drejtën ndërkombëtare dhe me Marrëveshjen e Dejtonit, e cila u ka dhënë fund luftimeve të periudhës 1992-1995 në Bosnje e Hercegovinë, dhe ka krijuar dy entitete, Federatën Myslimane-Kroate dhe Republikën Sërpska. Vuçiq u bëri thirrje përfaqësuesve të Republikës Sërpska që të gjitha problemet të zgjidhen në përputhje me Marrëveshjen e Dejtonit, ndonëse përsëriti se Serbia "nuk do t'i lërë kurrë në baltë serbët e Bosnjës".

Disa e panë këtë qëndrim të Vuçiqit si përpjekje "për t'i qetësuar nacionalistët në Bosnje e Hercegovinë".

Në Deklaratë përmendet që, në vend të 9 janarit, Republika Sërpska të shënojë ditën e shtetësisë më 15 shkurt, njëjtë sikurse Serbia.

Për disa serbë të Bosnjës, ky vendim përbën "tradhti për 9 janarin" - datë e shpallur jokushtetuese për një festë të tillë

në Bosnje e Hercegovinë, pasi përkon me nisjen e luftimeve në këtë shtet më 1992.

Ambasada amerikane në Sarajevë e cilësoi Deklaratën të rrezikshme, dhe me plot gabime. Në një postim në platformat sociale, Ambasada tha se "Republika Sërpska nuk është shtet dhe mund të ekzistojë vetëm brenda Bosnje e Hercegovinës".

## Pjesa për Kosovën

Pikat 11-14 i dedikohen Kosovës, e cila në Deklaratë konsiderohet si pjesë e patjetërsueshme e Serbisë. Aty përmendet që serbët në Kosovë, si dhe të gjithë qytetarët tjerë që janë besnikë ndaj Serbisë, duhet t'i mbrojnë manastiret, kishat, pronat private, varrezat dhe objektet tjera të rrezikuara.

Flitet edhe për "kushtet e patolerueshme të jetesës së serbëve" në Kosovë - pa përmendur ndonjë fakt konkret - dhe për nevojën për krijim të një Asociacioni të komunave me shumicë serbe.

Petritsch ka thënë se "udhëheqja në mbarë rajonin udhëzohet që të mos marrë hapa të njëanshëm që do të rrezikonin arritjet pozitive në dialogun" mes dy vendeve, i cili ndërmjetësohet nga BE-ja. Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, tha se Deklarata e

8 qershorit nuk përkon me qëndrimet e ShBA-së dhe as të vendeve tjera perëndimore.

## Mbështetja nga Rusia

Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, nga Moska u tha pjesëmarrësve se "Rusia nuk do t'i mbyllë kurrë sytë ndaj padrejtësive kundrejt popullit vëllazëror serb dhe tentimeve për t'i demonizuar ata".

Diplomati Petritsch i hodhi poshtë pretendimet e Lavrovit. "Nuk ka demonizim të serbëve. Kjo nuk është rruga përpara. Ne, në Evropë, duam vërtet të kemi marrëdhënie të mira me popujt e ish-Jugosllavisë. Ne nuk jemi kundër marrëdhënieve korrekte me Rusinë, apo me Kinën, mirëpo serbët duhet ta dinë që janë pjesë integrale e Evropës", tha ai. Serbia deklaroi se synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian, por mban lidhje të ngushta me Rusinë dhe refuzon ta sanksionojë atë - ndryshe nga blloku evropian -për luftën e nisur në Ukrainë më 2022.

Petritsch beson se serbët nuk përfitojnë thajse asgjë prej Rusisë, se bëjnë pak biznes me të dhe se janë larg edhe në aspektin geografik. "Serbia është pjesë integrale e historisë së Evropës, kulturës dhe politikës evropiane", tha ai.



# Një hap drejt paqes në Ukrainë



Josep **BORRELL**, përfaqësues i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri / Zëvendës-president i Komisionit Evropian

Samiti i Paqes i organizuar nga Zvicra do të bashkojë pothuajse 100 vende nga të gjitha pjesët e globit për të diskutuar se si të inicohet një proces për t'i dhënë fund luftës kundër Ukrainës. BE-ja i mbështet plotësisht këto përpjekje. Askush nuk dëshiron paqe më shumë se populli ukrainas, por paqja e qëndrueshme mund të arrihet vetëm nëse bazohet në parimet thelbësore të Kartës së OKB-së.

Këtë fundjavë do të marrë pjesë në Samitin e Paqes në Ukrainë në Zvicër. Kjo nuk është një platformë për negociata të drejtpërdrejta midis Ukrainës dhe Rusisë. Ky samit më tepër synon të zhvillojë midis vendeve pjesëmarrëse parametra të përbashkët për paqen, të bazuara në të drejtën ndërkombëtare dhe në Kartën e OKB-së.

Samiti do të përqendrohet gjithashtu në çështje praktike të përzgjedhura në të cilat të angazhohet Rusia: si të rritet siguria bërthamore, të lehtësohet shkëmbimi i robërve dhe të sigurohet kthimi i mijëra fëmijëve ukrainas të rrëmbyer në Rusi, një praktikë që ngjan në periudha më të errëta të historisë evropiane. Ai gjithashtu do të fokusohet në sigurimin e lundrimit të lirë dhe mbrojtjen e infrastrukturës

portuale të Detit të Zi. Ndikimi i luftës së agresionit kundër Ukrainës shtrihet shumë përtej kufijve të saj. Një konflikt i zgjatur ose i ngrirë do të përjetësonte paqëndrueshmërinë dhe do të kërcënonte sigurinë globale të ushqimit dhe stabilitetin ekonomik. Përparimi në këto fusha mund të hapë rrugë për angazhim me Rusinë në fusha të tjera me kalimin e kohës.

Kjo luftë dhe rezultati i saj janë ekzistenciale për Ukrainën, por edhe për sigurinë evropiane. Çdo armëpushim që do t'i lejonte Rusisë të mbante regjimin e saj represiv në territoret e pushtuara, do ta shpërblente këtë agresion, do të minonte të drejtën ndërkombëtare dhe do të inkurajonte zgjerimin e mëtejshëm territorial nga Rusia. Çdo raport i OKB-së që nga viti 2022 ofron prova të shumta të represionit brutal të ukrainasve dhe shkeljeve sistematike të të drejtave të njeriut në Ukrainën e pushtuar.

Rusia po bën një luftë të paprovokuar, e nxitur nga ambicia perandorake, ndërsa Ukraina po bën një luftë domosdoshmërie, duke mbrojtur të drejtën e saj për të ekzistuar.

Askush nuk e dëshiron paqen më shumë se ukrainasit. Megjithatë,

kushtet e duhura për paqe kanë rëndësi për Ukrainën dhe botën. Rusia po bën një luftë të paprovokuar që ka zgjedhur ta bëjë, e nxitur nga ambicia perandorake, ndërsa Ukraina po bën një luftë domosdoshmërie, duke mbrojtur të drejtën e saj për të ekzistuar. Siç tha përsëri Vladimir Putin në Shën Petersburg disa ditë më parë, ai synon fitoren e plotë në fushën e betejës dhe nuk sheh urgjencë për t'i dhënë fund luftës. Vetëm pak javë më parë, ai nisi një ofensivë të re kundër qytetit të Kharkivit. Raketat e tij kanë shkatërruar kryesisht infrastrukturën energjetike të Ukrainës dhe vazhdojnë të vrasin civilë ukrainas çdo ditë.

Ndërkohë, të dërguarit e tij bëjnë turne nëpër botë për të dekurajuar vendet që të angazhohen në Samitin për Paqe. Rusia padyshim nuk është e gatshme të angazhohet në negociata me mirëbesim dhe do të përdorte çdo armëpushim për t'u riamatosur dhe për të sulmuar përsëri. Narrativat e Rusisë rreth paqes janë thjesht përpjekje të maskuara për të legjitimuar luftën e saj të pushtimit territorial.

Rrjedhimisht, deklarata e Rusisë se nuk do të merrte pjesë në

samitin zviceran, edhe nëse do të ishte e ftuar, nuk ishte befasi. Megjithatë, pjesëmarrja e afro 100 vendeve dhe organizatave, nga Azia, Lindja e Mesme, Afrika dhe Amerika Latine, tregon mbështetje të fuqishme ndërkombëtare për t'i dhënë fund luftës në bazë të Kartës së OKB-së. Kjo është thelbësore për të siguruar Ukrainën, viktimë e luftës së agresionit të Rusisë, përpara çdo angazhimi të mundshëm me Rusinë.

Pjesëmarrja e afro 100 vendeve dhe organizatave, nga Azia, Lindja e Mesme, Afrika dhe Amerika Latine, tregon mbështetje të fuqishme ndërkombëtare për t'i dhënë fund luftës në bazë të Kartës së OKB-së.

Propozime të tjera do të diskutohen gjithashtu në Samit, por ne besojmë se formula e paqes prej 10 pikash e Ukrainës mbetet baza më e besueshme për negociatat e ardhshme të paqes. Propozimet që nuk i referohen Kartës së OKB-së dhe injorojnë sovranitetin politik, integritetin territorial dhe të drejtën për vetëmbrojtje të Ukrainës, do të përbënin shpërblimin e agresorit dhe legjitimimin e përpjekjeve të Rusisë për të rivizituar kufijtë me forcë. Propozime të tilla nuk mund të sjellin paqe të qëndrueshme. Në

këtë drejtim, mungesa e Kinës në Zvicër dhe shtrirja e saj për të dekurajuar pjesëmarrjen nuk i forcojnë pretendimet e Kinës për neutralitet.

BE-ja dëshiron paqe në Ukrainë. Një zgjidhje diplomatike që respekton normat ndërkombëtare do të kishte mbështetjen e të gjitha shteteve anëtare të BE-së. Në të njëjtën kohë, ne duhet të vazhdojmë t'i bashkojmë përpjekjet tona diplomatike me mbështetjen ushtarake, në përputhje me të drejtën e natyrshme të Ukrainës për vetëmbrojtje, sipas nenit 51 të Kartës së OKB-së. Duke pasur parasysh se Putini nuk tregon asnjë synim për të negociuar me mirëbesim, mbështetja e vazhdueshme ushtarake e Evropës për Ukrainën mbetet po aq vendimtare për paqen në Ukrainë sa mbështetja jonë për një rrugë diplomatike.

Po, luftërat përgjithësisht priren të përfundojnë me një marrëveshje paqeje, por përmbajtja e kësaj marrëveshjeje paqeje është thelbësore për sigurinë evropiane dhe globale, si dhe rëndin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Le ta bëjmë Samitin për Paqen në Zvicër një hap të parë drejt një paqeje të drejtë, të bazuar në Kartën e OKB-së në Ukrainë.

## Osmani takon në Shkup presidenten e Maqedonisë së Veriut, flasin për raportet bilaterale të dy vendeve

Shkup, 13 qershor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani po merr pjesë në Samitin e krerëve të shteteve të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) që po mbahet në Shkup.

Në këtë Samit, presidentja Osmani do t'i bashkohet krerëve të shteteve

pjesëmarrëse për të biseduar rreth thellimit të bashkëpunimit me vendet e rajonit dhe partnerët ndërkombëtarë për të garantuar paqe, siguri, stabilitet, zhvillim ekonomik, politik e shoqëror në rajon.

Në kuadër të këtij samiti, Osmani ka takuar presidenten e Maqedonisë së Veriut, Gordana

Siljanovska-Davkova. "Edhe një herë, presidentes ia urova marrjen e detyrës, gjersa diskutuam edhe për raportet bilaterale Kosovë-Maqedoni e Veriut, si dhe për thellimin e bashkëpunimit në dobi të qytetarëve të të dy shteteve tona", ka shkruar Osmani në "Facebook".





## Kosova bëhet anëtare e koalicionit të deminimit për Ukrainën

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Kosova ka bërë një hap të rëndësishëm në përfaqësimin dhe rolin e saj në sigurinë globale. "Sot në Bruksel me ministrin e Mbrojtjes të Lituanisë, Laurynas Kasciunas, nënshkruam marrëveshjen e përbashkët sipas të cilës Kosova edhe zyrtarisht është pjesë e Koalicionit të Deminimit për Ukrainën, duke u bërë kështu shteti i

17-të anëtar i këtij koalicioni që ka për qëllim ofrimin e mbështetjes për Ukrainën përmes ofrimit të trajnimit në fushën e deminimit, zotim ky që e kemi dhënë si pjesë e Grupit të Kontaktit për Ukrainën, e që është një hap tjetër i ndërmarr nga ana e Kosovës për popullin ukrainas pasi veçse tanimë kemi dorëzuar dy pako mbështetëse ushtarake", ka thënë ministri i

Mbrojtjes së Kosovës, Ejup Maqedonci. Ai ka thënë se ushtarët tanë do të rreshtohen përkrah partnerëve tanë në këtë front global demokratik kundër agresionit dhe dhunës. "Kosova do të vazhdojë të qëndroj krah Ukrainës ngase jemi me të drejtën, lirinë e popujve dhe të drejtat demokratike të shteteve", ka thënë Maqedonci.



REAGIM I KMDLNJ-së

# Me çka të krenohemi për 25-vjetorin e çlirimit?!

Dje në Prishtinë u festua 25 vjetori i çlirimit të Kosovës përmes aktiviteteve të ndryshme e që dominante ishte parakalimi i FSK-së dhe Policisë së Kosovës, si veprim që u përshëndet nga shumë qytetarë të Kosovës dhe të ardhur nga diaspora. Në çadrën e improvizuar ishin mysafirë të ftuar nga jashtë e që kishin shërbyer në Kosovë gjatë dhe pas përfundimit të luftës, ushtarakë dhe politikanë. Përfaqësues të institucioneve të Kosovës që nuk kishin dhënë asnjë kontribut për çlirimin e vendit ishin në radhët e parë kurse ata që sakrifkuan personalisht dhe familjarisht ishin në rreshtin e parafundit. Çfarë injorimi i çlirimtarëve nga injorantët e pushtetshëm!

### Po si e gjeti Kosovën 25-vjetori i çlirimit?

Paradoksalisht dhe pashpjegueshëm nga aspekti logjik, i arsyes dhe material, Kosova, në vend të jetë afër integritit në BE, është nën maskën e sanksioneve për më tepër se një vit, pa asnjë njohje ndërkombëtare gjatë këtij mandati afërsisht të plotë qeverisës dhe plotësisht e dështuar në anëtarësim në institucionet ndërkombëtare ndërkrah dështimi kapital ishte mosanëtarësimi në Këshillin e Evropës. Realisht, Kosova është pa Ministri të Jashtme funksionale. Në aspektin e mirëqenies ekonomike dhe sociale qytetarët e Kosovës po bëjnë luftë për mbijetesë duke u përballur me rritje të papërballueshme të çmimeve të artikujve elementarë ushqimorë, rritje jonormale të faturave të rrymës dhe shërbimeve. Kategoritë më të



cenueshme të qytetarëve të Kosovës siç janë pensionistët, përfituesit e skemave sociale, të luftës dhe veteranët e UÇK-së brutalisht po dhunohen nga një ministër i papërgjegjshëm, jonjerëzor dhe mohues që, për dallim nga ministrat e shteteve fqinje, këtyre kategorive për asnjë cent nuk ua ka rritur pensionet ndonëse në vendet fqinje pensionet janë rritur disa herë dhe përcjellin shkallën e inflacionit. Ministri aktual i financave në Kosovë ndaj këtyre kategorive po e zbaton eutanazinë materiale që nënkupton që jo se nuk ka bërë asgjë për përmirësimin e cilësisë së jetës, përkundrazi, edhe vdekjen ua ka bërë më të padinjitetshme. Çfarë dhunuesi i të drejtave të njeriut! Arsimi më shumë prodhon analfabetë jofunksionalë se analfabetë

funksionalë sepse udhëhiqet nga një analfabete krejtësisht e paaftë për postin që e mbanë. Sikur edhe ministratë tjera, me përjashtime simbolike.

Në datat simbolike të burgosurit shprehëjnë dhe presin mëshirën e shtetit e cila nuk iu mohohet as në regjimet më diktatoriale. Në Kosovë kjo e drejtë iu mohohet 100 për qind nga një presidente që brutalisht e shpërdoron të drejtën që ia jep Kushtetuta e Kosovës për të falur të burgosur që i plotësojnë kushtet e parapara me ligj dhe që këtë falje e kanë merituar me sjellje të mirë. Askush normal në Kosovë nuk mund të besojë dhe të bindet që asnjëri nga, së paku 1600 të burgosur në Kosovë nuk e meriton falje nga presidentja me rastin e 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës. KMDLNJ, me të drejtë ka pritur se në këtë përvjetor jubilar të 25

vjetorit të çlirimit të Kosovës, presidentja e Kosovës do të falë një numër të të burgosurve. Në vend të këtij lajmi e që në fakt nuk do të duhej të ishte lajm për një vend dhe shtet normal, në ditën e festimit të 25 vjetorit të çlirimit të Kosovës, KMDLNJ u informua se edhe një i burgosur vdiq në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë - Hajvali. Në vend se kjo datë dhe ditë jubilarë e 25 vjetorit të çlirimit të Kosovës të shërbejë për shprehje të respektit ndaj atyre që tërë jetën ia kushtuan luftës për çlirim duke e formuar dhe udhëhequr Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, shtetndërtimit dhe konsolidimit të paqes e që tash janë në Burgun e Hagës duke u përballur me një proces ekskluzivisht në baza etnike, presidentit Hashim Thaçi, kryekuvendarëve Jakup Krasniqi

dhe Kadri Veseli si dhe shefit të GP të IV-së, Rexhep Selimi, absolutistët e pushtetit aktual nuk denjuan as që t'i përmendin duke e retushuar të kaluarën e lavdishme të çlirimtarëve. Përpjekje flagrante e ndryshimit të historisë. Parakalimi i FSK dhe Policisë së Kosovës ishte vetëm një fasadë prapa së cilës po bëhen përpjekje të fshehët dhe manipulohet gjendja e rëndë e një numri të madh të qytetarëve të Kosovës që marrin kredi dhe hyjnë në borxhe për t'i shlyer faturat që janë bërë të papërballueshme. Për fat të keq sot qytetarët e Kosovës kanë mbetur në mëshirën e institucioneve të papërgjegjshme të Kosovës dhe përmbaruesve grabitqarë, si "garantues" për mbrojtjen e të drejtave njerëzore të tyre, hiç atyre që në një numër të madh e kanë lëshuar Kosovën!!!

## Nga 1 janari në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike janë kryer 3 mijë e 98 lindje

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Nga 1 janari i këtij viti, në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike, të

Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës, janë kryer 3 mijë e 98 lindje, prej

tyre 1 mijë e 247 me operacion. Në klinikë janë kryer edhe 1 mijë e 664 operacione të

llojeve të ndryshme. Nuk është regjistruar asnjë rast i vdekjes.





# Kosova vendos sanksione kundër Rusisë, Bjellorusisë dhe Iranit

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar të enjten pakot sanksionuese ndaj Rusisë, Bjellorusisë dhe Iranit.

Kabineti qeveritar miratoi propozim-vendimin e zbatimit nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të BE-së për vendosje të masave kufizuese ndaj Republikës Islamike të Iranit, propozim-vendimin për plotësimin e vendimit të Qeverisë nr.01/64 të datës 25 shkurt 2022 të për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të BE-së dhe ShBA për vendosje të sanksioneve ndaj federatës Ruse dhe Bjellorusisë në raport me situatën në Ukrainë dhe propozim-vendimin për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të BE-së për vendosje të masave kufizuese lidhur me shkeljen serioze dhe abuzimin me të

drejtat e njeriut në federatën ruse. Zëvendësministrja e MPJD-së, Liza Gashi derisa shtjelloi këto masa tha se njëra nga sanksionet ndaj federatës ruse lidhet me vrasjen e liderit opozitarë rus Alexei Navalny. "Në vazhdim të mbështetjes së kundërshtimit të agresionit rus ndaj Ukrainës dhe në përputhje me sanksionet e BE-së dhe ShBA-së, MPJD propozon për shqyrtim dhe miratim vendimet për zbatimin e pakos së 12 dhe 13 të sanksioneve të BE-së ndaj federatës ruse për cenim dhe kërcënim të integritetit territorial. Sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës dhe sanksione tjera për shkelje të rënda dhe abuzime të rënda me të drejtat e njeriut që lidhen me vrasjen e liderit opozitarë rus Alexei Navalny. Gjithashtu edhe pakon e sanksioneve ndaj Iranit gjegjësisht ndaj personave të



subjekteve të përfshirë në aktivitetet e raketave bërthamore dhe personave që ofrojnë

mbështetje për qeverinë e Iranit", tha Gashi. Kosova ka qenë pjesë e shteteve

perëndimore që kanë sanksionuar Rusinë për luftën në Ukrainë që kur nisi në vitin 2022.

## Kusari: LV-ja ka injoruar 83 për qind të rekomandimeve të KiE-së për Projektligjin për KPM-në

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Juristja e të drejtës së mediave, Flutura Kusari, është shprehur e shokuar me refuzimin që Lëvizja Vetëvendosje ua ka bërë rekomandimeve të Këshillit të Evropës për çështjen e Projektligjit për Komisionin e Pavarur për Media (KPM).

Ajo ka bërë me dije se partia në pushtet ka injoruar 83 për qind të këtyre rekomandimeve. "Kuvendi i Kosovës është duke e ndryshuar Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media (KPM). Projektligji është draftuar nga Zyra e Kryeministrit Kurti dhe ndryshimet janë sikur ato që i kishte propozuar zyra e kryeministrit Edi Rama në Shqipëria (pakoja Anti-shpifje). Qëllimi i ndryshimit të këtij projektligji është kontrollimi i medieve online dhe kapja politike e KPM-së. Nuk ka asnjë qëllim tjetër. Së bashku me AGK-në dhe KSHMK-në patëm thirrur konferencë për shtyp në të cilën patëm thënë që projektligji shkel



në mënyrë flagrante standardet e Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian dhe OSBE-së. Përgjigja e deputetëve të LV-së ndaj reagimit tonë ka qenë - kjo është dezinformata. Këshilli i Evropës, pasi gjeti që projektligji devijonte

nga standardet Evropiane - fjala devijim përdoret në analizë - përmes një analize ligjore pati ofruar 12 rekomandime për të përmirësuar projektligjin. Pra reagimi ynë nuk ishte dezinformata por një ekspertizë e

nivelit superior. Po ashtu, Forumi për Integritet të Informacionit (NDI) i pati dërguar Komisionit për Media komente për të përmirësuar draftin. Në këtë mënyrë, Komisioni për Media ka pasur mundësi që duke i adresuar

rekomandimet e Këshillit të Evropës, të Forumit etj, të draftonte një nder ligjet më të mira në Evropë. Por çka bën LV-ja? LV-ja vendos që të injorojë 83% të rekomandimeve të Këshillit të Evropës", ka shkruar në "Facebook" Kusari.

Ajo ka thënë se përmes ECPMF-së ka monitoruar ndryshime të ligjeve për medie në disa shtete të Evropës. "Asnjëherë nuk kam pa injorim kaq të madh të rekomandimeve të Këshillit të Evropës. P.sh në Shqipëri, Edi Rama nuk e vazhdoi aventurën e tij me pakon Anti-shpifje pikërisht pasi Këshilli i Evropës e kritikoi përmes një opinionimi ligjor. Sot Komisioni për Integrim Evropian në parlament do ta diskutojë dhe me siguri do ta aprovojë brenda 30 sekondave projektligjin, ndonëse ka opinion ligjor zyrtar nga këshilli i Evropës që thotë që projektligji nuk është në pajtim me standardet evropiane", ka theksuar Kusari.

## Walker: Kosova është storie suksesi, meritat i takojnë popullit të saj

PRISHTINË, 13 QERSHOR- Ish-shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së gjatë luftës në Kosovë, William Walker është takuar të enjten me kryeministrin Albin Kurti.

Ai ka thënë para medieve se takimi që zgjati për më shumë se një orë ishte një takim shumë i mirë dhe produktiv. Walker shtoi se Kosova është storie suksesi për arritjet që ka bërë përgjatë 25 vjetëve të çlirim. "Sapo pata një takim për më shumë se një orë me kryeministrin dhe ishte takim shumë i mirë dhe shumë produktiv. Nuk përdori kod të

veshjes kur takoj kryeministrin, do duhej të kisha veshje zyrtare me kravatë, gjatë dy ditëve të fundit kisha takime të shumta dhe tani e kisha veshjen time të stilit të Kalifornisë sepse erdha këtu si mik i Kosovës si mik i kryeministrit Kurti", tha Walker.

Miku i madh i Kosovës shtoi se meritat kryesore për të arriturat e Kosovës janë vet populli i saj. Ai pati edhe disa lëvdata për gazetarët, ku u tha se duhet të ndjeheni mirë që jeni gazetarë dhe shqiptarë po ashtu. "Dje, e di se u folën



shumë fjalë duke i dhënë meritat NATO-s, duke i dhënë meritat disa prej akterëve të tjerë ndërkombëtarë që ishin këtu. Mendoj që meritat kryesore i shkojnë kosovarëve për atë që kanë bërë deri me tani, si kryeministrit Kurti dhe kryeministrave tjerë të kaluar, e po ashtu edhe forcave policore. Nuk mendoj se e dini sikurse unë çfarë forcash policore të mira keni, edhe në Amerike kemi policë të mirë, disa po e disa më ndryshe, por ju në Kosovë keni një polici të shkëlqyer", tha Walker.



## Klubi i Biznesit zhvillon takim me Departamentin e Tregtisë së ShBA-së në Uashington

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Klubi i Biznesit ka njoftuar se ka pasur një takim shumë produktiv me Departamentin e Tregtisë së ShBA-së në Uashington. Sipas njoftimit, gjatë takimit diskutimet u përqendruan në forcimin e lidhjeve ekonomike midis Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara, eksplorimin e rrugëve të reja

për nxitjen e partneriteteve që mund të nxisin rritjen dhe inovacionin në të dyja rajonet. "Pikat kryesore nga takimi ishin strategjitë për të përmirësuar marrëdhëniet tregtare bilaterale; Mundësitë për bizneset e Kosovës në tregun e ShBA-së dhe anasjelltas; Iniciativa bashkëpunuese për të nxitur investimet dhe zhvillimin

ekonomik. Ky takim shënon një hap të rëndësishëm përpara në misionin tonë për të promovuar potencialin e biznesit të Kosovës në një skenë globale. Jemi optimistë për të ardhmen dhe mezi presim mundësitë e mrekullueshme që na presin përpara", është thënë në njoftimin e Klubit të Biznesit.



## Kurti: Krahasuar me katër vitet më parë, sivjet e kemi 50% më të lartë Bruto Produktin Vendor

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të enjten mbledhjen e 208-të. Kryeministri Albin Kurti ka uruar anëtarët e kabinetit qeveritar për 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës, duke theksuar se

asnjëherë nuk është mjaftueshëm të shprehim mirënjohjen dhe nderimet për të gjithë ata e ato që sakrifkuan për liri. "U jemi përjetësisht falënderues edhe miqve e aleatëve tonë ndërkombëtarë. Në mbledhje po vij nga takimi me mikun e madh të Kosovës e të vërtetës, diplomatin amerikan William Walker. Ky njeri i jashtëzakonshëm, ishte ai që ngriti zërin për padrejtësitë dhe mizoritë të cilat po ndodhnin në vendin tonë. Me guxim dhe integritet, ambasadori Walker dhe Misioni Verifikues i OSBE dokumentuan dhe dëshmuuan krimet e rënda që po kryheshin nga Serbia ndaj popullit tonë", ka theksuar Kurti.

Ai ka pohuar se raportet nga terreni shërbyen si një thirrje për ndërgjegjen ndërkombëtare dhe nxitën reagimin e komunitetit ndërkombëtar. "Ai angazhim dhe ato dëshmi ishin katalizatorët që çuan në ndërhyrjen e NATO-s. Puna dhe përkushtimi i ambasadorit Walker me ekipet e tij ishin thelbësore për të nxjerrë në dritë të vërtetën dhe për të siguruar mbështetjen ndërkombëtare që na ndihmoi të



arrijmë lirinë tonë. Andaj një falënderim i veçantë për të gjithë ato gra e burra, anëtarë të Misionit Verifikues në Kosovë të OSBE-së, rreth 1400 sosh, mirënjohje për secilën e secilin që u angazhuan në këtë mision për afro gjashtë muaj, nga tetori i vitit 1998-të deri në marsin e vitit 1999-të", është shprehur Kurti. Kryeministri Kurti ka bërë me dije se ekonomia e vendit tonë apo Bruto Produkti Vendor sivjet do të jetë pesë herë e gjysmë më i madh sesa në vitin 2000. "Nuk po e krahasojmë me vitin 1999, kur ishte vit i kthimit të refugjatëve pas luftës, por po e krahasojmë me vitin 2000. Pas më pak se 25 vjetësh ekonomia është rritur

pesë herë e gjysmë. Ndërkaq, krahasuar me vitin kur është shpallur pavarësia 2008, sivjet do ta kemi Bruto Produktin Vendor gati tri herë më të madh se sa në atë vit, kurse krahasuar me katër vjet më herët e kemi sivjet 50% më të lartë Bruto Produktin Vendor. Qytetarët gjithashtu janë më të lirë dhe shteti është më i pavarur e më i zhvilluar se kurdoherë më parë. Demokracia është përherë e më e shëndoshë, e qeverisja po bëhet përherë e më e mirë. Pra çlirimi, sakrificat gjithëkombëtare e ndër gjenerata, shpallja e pavarësisë ia kanë vlejtur fort, edhe në aspektin e rritjes ekonomike edhe në aspektin e demokracisë qytetare",

ka deklaruar Kurti, duke shtuar se puna e qeverisë vazhdon. Kurti ka thënë se në këtë mbledhje, mes vendimeve të rëndësishme e kemi një më të veçantë, e të rëndësishme. "Për herë të parë pas përfundimit të luftës, Republika e Kosovës do të ketë Strategji për Drejtësi Tranzicionale. Populli i Kosovës ka kaluar nëpër sfida të mëdha, ka përjetuar dhimbje e vuajtje të pamatshme. Ky dokument strategjik është edhe një hap përpara në përpjekjet tona për të adresuar plagët e së kaluarës dhe për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë për të gjithë qytetarët tanë. Miratimi i kësaj strategjie është vetëm hapi i parë. Zbatimi i

saj kërkon përkushtim, bashkëpunim dhe mbështetje nga të gjithë ne", ka thënë kryeministri, duke shprehur mirënjohje për angazhimin dhe kontributin e të gjithëve në procesin e hartimit dhe të konsultimeve: institucionet e Republikës, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, studiues e aktivistë të të drejtave të njeriut, punonjësit e arsimit, intelektualët, gazetarët, bashkësitë fetare në Kosovë, profesionistët juridikë, të sektorit të sigurisë, punëtorët socialë, e mbi të gjitha viktimat, të mbijetuarit e krimeve të kryera gjatë të luftës dhe familja e secilës e secilit prej tyre.

## Qeveria e Kosovës ndan 3 milionë euro për mbulim policës kufitare për mërgimtarët

Prishtinë, 13 qershor - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndarjen e 3 milionë eurove për mbulim policës kufitare për mërgimtarët.

Me këtë rast, ministri i Financave, Punës dhe Trasfereve, Hekuran Murati, ka thënë se ky vendim ka të bëjë me mbështetjen për mërgatën. "Ky vendim ka të bëjë me masa mbështetëse për mërgatën tonë, i cili

parasheh mbulimin e policës kufitare për bashkatdhetarët që vijnë në Republikën e Kosovës për kohën sa qëndrojnë këtu", ka thënë Murati.

Në këtë mbledhje të qeverisë u miratua edhe nisma për negociimin e marrëveshjes së grantit në vlerë 5.33 milionë dollarë amerikanë në kuadër të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

(SDC) financim shtesë i siguruar përmes negociimit të marrëveshjes fillestare në kuadër të projektit Flows me vlerë 25.1 milionë euro të miratuar tashmë në Kuvendin e Kosovës. Përmes këtij projekti mundësohet forcimi i kapacitetit kombëtar për menaxhimin e sigurisë së ujit dhe përmirësimi i sigurisë së ujit në pellgun Morava e Binçës






# Burrat që u arratisën nga Alkatrazi – me lugë!

Nga: Myles Burke / BBC

Në maj të vitit 1964, Michael Charltoni i emisionit Panorama të BBC-së, nëpër ujërat e trazura të Gjirit të San Franciskos kreu “udhëtimin më të frikshëm në botën kriminale” për të parë ishullin famëkeq të burgut të Alkatrazit. I mbiquajtur “Shkëmbi”, burgu federal mbante disa nga kriminelët më të rrezikshëm në ShBA. Konsiderohej si kështjellë e pathyeshme. Por, në orët e hershme të 12 qershorit 1962, tre burra arritën atë që mendohej si e pamundur: u arratisën.

Alkatrazi fillimisht ishte fortesë detare për të mbrojtur hyrjen në gj. Gjatë Luftës Civile në ShBA, për shkak të izolimit të ishullit, shkëmbinjtë të thepisur dhe rrymave të shpejta e të ftohta që e rrethonin, atje u mbajtën të burgosurit e arrestuar të konfederatës. Në fillim të shekullit XX u rindërtua si burg ushtarak. Në vitet 1930, derisa ShBA-ja përpitë të merrej me krimin e shfrenuar të organizuar që lulëzoi gjatë prohibicionit, Departamenti i Drejtësisë merr kontrollin e tij. Shumë shpejt nisën të vinin të dënuarit më të frikshëm nga sistemi federal i burgjeve. Ndër të burgosurit më të famshëm ishin gangsterët famëkeq Al Capone, Mickey Cohen dhe George “Machine Gun” Kelly, si dhe vrasësi i dënuar Robert Stroud i cili më vonë do të bëhej i njohur si “Njeriu zog [Birdman] i Alkatrazit”. “Burra shumë të këqij dhe problematikë për t’u mbajtur në një burg të zakonshëm”, ishte mënyra se si Charltoni i BBC-së e përshkroi situatën.

Katër vjet përpara se Panorama të udhëtonte atje, Frank Lee Morris kishte mbërritur në ishull. I mbetur jetim në moshën 11-vjeçare dhe i dënuar për krimin e tij të parë në moshën 13-vjeçare, Morrisi e kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës brenda dhe jashtë institucioneve të ndryshme korrektuese. I vlerësuar si shumë inteligjent, ishte kriminel i rryer, me një mori të akuzave që shkonin nga posedimi i drogës e deri të grabitja e armatosur dhe, ndoshta më e rëndësishmja – arratisjet nga burgu. U dërgua në Shkëmb në janar 1960, pas arratisjes së tij nga burgu shtetëror i Luizianës. Sapo mbërriti në Alkatraz, nisi të mendojë se si do të largohej. Qelia e tij ishte ngjitur me qelitë e vëllezërve John dhe Clarence Anglin dhe Allen Westit – të cilët ishin dënuar për grabitje



bankash dhe të cilët ishin në burg në Alkatraz që nga viti 1957. Të gjithë burrat e njihnin njëri-tjetrin nga periudhat e mëparshme të përbashkëta në burgje dhe, meqë i kishin qelitë pranë njëri-tjetrit, kishin mundësi të flisnin gjatë natës. Kur Charltoni i BBC-së e vizitoi lokacionin, një vit pas mbylljes, ishte i vetëdijshëm për reputacionin e frikshëm që kishte burgu për rojet e pamëshirshme, për kushtet e vështira dhe erërat ndëshkuese të detit të cilat të dënuarit duhej t’i duronin. “Një erë e pamëshirshme që dukej se nuk ndalet kurrë, që ulërin dhe jehon nëpër hekur”, tha ai. “Ndërtuar mbi fragmentet e hallakatura të një fortese të vjetër ... themelet e Alkatrazit sot po kalben dhe po prishen”. Me Morrisin që merr drejtimin, të katër të burgosurit nisën të sajajnë planin e përpunuar dhe të guximshëm për t’u arratisur. Gjatë një periudhe prej disa muajsh, burrat e copëtuan betonin e dëmtuar nga kripa rreth kanalit të ajrit nën lavamanët e tyre. Duke përdorur lugët metalike të nxjerra nga salla e ngrënies, një shpuese e punuar nga një motor i fshesës me korrent dhe tehet e hedhura të sharrës, ata gërmuan në një korridor të pambrojtur. Për të maskuar zhurmën e shpimit, Morris i binte fizarmonikës së tij gjatë orëve të caktuara ditore kur duhej të bënte muzikë për të burgosurit. Pasi e krijuan një vrimë mjaft të madhe për t’u zvarritur deri në korridor, u ngjitën në nivelin e sipërm bosh të bllokut të qelisë dhe krijuan një punëtori sekrete. Për të fshehur vrimat e mureve të qelisë, bënë grila të rreme me letra [teknika papier-mâché] nga revistat e bibliotekave të burgut. Kur ishin në punëtori, nisën ndërtimin e një gomone të improvizuar 183 me 427 centimetra dhe jelekët e

shpëtimit të punuar nga më shumë se 50 mushama të vjedhura. Për të ngjitur gomën, atë e shkrinin duke përdorur gypat e avullit të nxehtë të burgut. Më pas harmonikën e kthyen në mjet për të fryrë gomonen, ndërsa lopatat i punuan nga kompensata. Por, teksa punonin, duhej ta fshihnin mungesën nga rojet që bënë kontrollin periodik gjatë natës. Kështu, i skalitën versionet e kokave të tyre të punuara nga letra, sapuni, pasta e dhëmbëve dhe letra higjienike. Për t’i bërë që të duken më realiste, përdorën flokë të vërtetë nga dyshemeja e berberit të burgut dhe i lyen me tone lëkure duke përdorur materiale të vjedhura arti. Këto do t’i vendosnin në shtretër, me grumbuj rrobash dhe peshqirësh nën batanije në formën e trupit të tyre, që të dukeshin sikur ishin në gjumë. Teksa punonin për pajisjet e tyre të improvizuara të arratisjes, gjithashtu e kërkonin një rrugëdalje. Duke përdorur tubacionet hidraulike si shkallë, u ngjitën 9.1 metra dhe hoqën ventilatorin në maje të një kanali. E krijuan një shul të rremë nga sapuni për ta mbajtur në vend.

Më në fund, në natën e 11 qershorit 1962, ishin gati për të vënë në lëvizje planin e tyre të zgjuar. Duke lënë kokat e rreme në shtretërit e tyre për të mashtruar rojet, Morrisi dhe dy vëllezërit Anglin u zvarritën nëpër vrimat e mureve të qelisë. Arratisja e Westit dështoi meqë nuk ia doli të dilte me kohë nga qelia, kështu që të tjerët u larguan pa të. U ngjitën në çatinë e qelisë, vrapuan duke e kapërcyer – duke mbajtur varkën e tyre të improvizuar para kullës së rojeve – u hodhën poshtë përmes një tubi të kullimit të jashtëm, e kaluan oborrin e burgut, u ngjitën në dy gardhe të njëpasnjëshme me

tela me gjemba (3.7 metra) dhe u zhdorgjën poshtë argjinaturës së pjerrët në bregun verilindor të ishullit. Buzë ujit e frynë varkën dhe u zhdokën gjatë natës. Alarmi nuk u dha deri në mëngjesin e ardhshëm kur u zbuluan kokat e rreme. Ishulli ishte gjithashtu shtëpia e familjeve të rojeve që punonin në burg. Babai i Jolene Babyakut, i cili në atë kohë ishte ushtrues detyre i rojës në Alkatraz, e lëshoi alarmin. “Kur u zgjova, sirena vazhdonte. T’i shponte veshët, ishte jashtëzakonisht e zhurmshme, e tmerrshme, shumë e frikshme”, tha ajo në emisionin Witness History të BBC-së në vitin 2013. “Isha e tronditur dhe mendimi im i parë ishte se kjo nuk mund të jetë tentativë arratisjeje, por sigurisht që ishte”. Burgu përjetoi izolim të menjëhershëm me kontroll intensiv të të gjitha ndërtesave, përfshirë akomodimin e oficerëve të burgut. Ndërkohë, babai i Jolene nisi gjuetinë masive me qindra vetë nga personeli i zbatimit të ligjit, të cilët për ditë të tëra kërkonin gjerësisht në zonën përreth. Më 14 qershor, roja bregdetare gjeti një nga lopatat e të burgosurve. Po atë ditë, punëtorët gjetën një pako me sendet personale të Anglinëve, të mbyllura në gomë. Shtatë ditë më vonë, disa mbetje të gomones u lanë pranë urës së Portës së Artë [Golden Gate] dhe të nesërmen u zbulua një nga jelekët e shpëtimit të punuar me dorë. Por, tre të arratisurit nuk u panë më kurrë. Edhe pse të burgosurit ikën nga burgu, autoritetet arritën në përfundimin se kanë mundur të mbyten në ujërat e pabesë, në përpjekjen për t’u larguar nga ishulli. Kjo padyshim ishte pikëpamja e drejtorit të burgut Richard Willard, kur BBC e intervistoi më 1964. “Po, na ikën disa, por ata nuk po mburren për këtë. Me fjalë të tjera, sipas

nesh, supozohet se të gjithë ata që ikën u mbytën; askush nuk është parë rrugëve duke u mburrur se ka ikur nga Alkatrazi”, tha ai. “Pse jam kaq i sigurt? E dëgjon erën, apo jo? Dhe, e sheh ujin? Mendon se mund t’ia dalësh?”

Burgu i Alkatrazit u mbyll në vitin 1963, një vit pas arratisjes së burrave. Kjo pjesërisht ndodhi për shkak të strukturës së përkeqësuar dhe shpenzimeve për drejtimin e tij, por regjimi i ashpër i burgut ishte prej kohësh gjithashtu objekt i polemikave. Qysh në vitin 1939, Prokurori i Përgjithshëm i ShBA-së, Frank Murphy, u përpoq ta mbyllte duke thënë: “I gjithë institucioni është i favorshëm për psikologjinë që krijon qëndrim të keq dhe vicioz mes të burgosurve”.

Me kalimin e viteve, të burgosurit kishin vrarë ose gjymtuar veten – të paafte për t’u përballur me kushtet e rrepta – dhe në vitet 1960 ShBA-ja shkante drejt rehabilitimit të të burgosurve dhe jo vetëm dënimit të tyre.

Sa i përket tre të arratisurve, pavarësisht se nuk u gjetën trupat në gj, në vitin 1979 u shpallën ligjërisht të vdekur. FBI-ja e mbylli çështjen dhe ia dorëzoi përgjegjësinë Shërbimit të Mareshalëve të ShBA-së.

Por, spekulimet për fatin e tyre nuk janë zbehur kurrë. Në të njëjtin vit kur u shpallën të vdekur, u publikua filmi Arratisja nga Alkatrazi me Clint Eastwoodin që portretizonte Frank Morrisin. Dhe, që nga momenti i arratisjes së tyre në vitin 1962, pati raportime për hasjen e supozuar të burrave dhe për mesazhet e tyre.

Në vitin 2018, policia e San Franciskos zbuloi se pesë vjet më parë pranoi një letër misterioze, nga dikush që pretendonte se ishte John Anglini. Në letër thuhej: “U arratisa nga Alkatrazi në qershor 1962. Po, të gjithë ia dolëm atë natë, por me shumë vështirësi!” Letra pohoi se burrat kishin jetuar në fshehtësi, se Frank Morrisi vdiq në tetor 2005 dhe Clarence Anglini më 2008. Autori i letrës tha se ai tani donte të negocionte dorëzimin, në këmbim të trajtimit të kancerit. FBI e vlerësoi letrën, por nuk ishte në gjendje të verifikonte nëse ishte autentike ose jo.

Çështja është ende e hapur për Shërbimin e Mareshalëve të ShBA-së. Në vitin 2022 publikoi fotografi të përditësuar të asaj se si mund të dukeshin tani tre të burgosurit e zhdokur të Alkatrazit, ndërsa bëri thirrje për çdo informacion rreth tyre, me shpresën se më në fund mund ta zgjidhnin misterin.

/Telegrafi/



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Yllka Shatri vazhdon karrierën në Islandë

ISTOG, 13 QERSHOR - Pivotja e Përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Yllka Shatri ka bërë lëvizje të rëndësishme në karrierë. Yllka është prezantuar te skuadra nga Islanda, IBV Handbolti. Me IBV, Yllka ka firmosur për një vit, me mundësi të vazhdimet edhe për një vit tjetër. Prej fillimit të karrierës ajo ishte tek Istogu, me të cilën skuadër për gjashtë vjet

luajti në Evropë dhe fitoi shumë trofe në hendbollin kosovar. Tani Yllka ka para vetes një sfidë të re, që pritet ta ngritë edhe më lartë si lojtare. “Përmes agjencisë që më përfaqëson erdhi oferta e klubit nga Islanda, IBV Handbolti. Kisha edhe disa oferta nga vende të tjera, por vendosa për këtë në Islandë. Skuadra ime e re luan po ashtu në kupa evropiane. Vjet u ndal

në raundin e tretë të Kupës Evropiane. Hendbolla në Islandë është cilësor, liga është interesante. Luhet pak më ndryshe se te ne në Kosovë dhe besoj se do të përfitoj shumë në karrierë nga përvoja në këtë vend. Kam vendosur për Islandë edhe për faktin se ky vend është goxha i veçantë. Të shohim si do të shkoj, shpresoj sa më mirë”, ka theksuar Shatri. Te klubi

islandez presin shumë nga hendbollistja e Kosovës. “Lojtarja e vijës nga Kosova, Yllka Shatri ka firmosur me klubin tonë. Yllka vjen nga KHF Istogu që u bë kampion i Kosovës. Yllka është e gjatë 180 centimetra dhe pivote e fuqishme. Kemi shpresa të mëdha për Yllkën dhe mezi presim ta shohim në fushë”, ka shkruar IBV në faqen zyrtare.



## Sonte fillon ‘Euro 2024’, nesër Shqipëria përballlet me Italinë

### “Epoka e re”

MUNCHEN, 13 QERSHOR - Sonte (e premte) tifozët do të zbrisin në “Allianz Arena” në Munchen për ngritjen e perdes së shumëpritur për “Euro 2024”, ndërsa Gjermania që është nikoqire do të nisë këtë kampionat ndaj Skocisë në kuadër të Grupit A. Për “Die Mannschaft”, Kampionati Evropian është një mundësi e shkëlqyeshme për të korrigjuar disa dështime të fundit, ndërsa njerëzit e Steve Clarke janë ende duke pritur për paraqitjen e tyre të parë në raundin e nokautit. Pavarësisht dështimit të madh në Kampionatin e fundit Botëror, Gjermania e Nagelsmannit po llogaritet favorit në këtë ndeshje, por edhe ndër favoritët kryesor për të fituar trofeun. Trajneri i Gjermanisë, Julian Nagelsmann është entuziazmuar që “Euro



2024” po mbahet në vendin e tyre dhe beson në sukses. “Është hera e dytë që Gjermania pret një kampionat evropian. Për lojtarët dhe për mua si menaxher, të marrë pjesë në një turne në si vendas është një mundësi unike. Ka presion, por më shumë gëzim dhe nëse mund ta shohim atë gëzim në fushë, atëherë do të kemi një turne të mrekullueshëm”. Në anën tjetër, Steve Clarke, trajneri i Skocisë, ka thënë se Gjermania ka një skuadër cilësore dhe do të mundohet të mos zhgënjë tifozët. “Gjermania do të jetë shumë e mirë. Është turne i tyre në shtëpi dhe ata nuk

do të mundohen të mos zhgënjë askënd. Në eventet e tilla, Gjermania është gjithmonë një nga ekipet më të rrezikshme. Ne presim një lojë të vështirë, por shpresojmë se do t’i paraqesim Gjermanisë një lojë të vështirë”, ka deklaruar Clarc. Pjesë e këtij kampionati Evropian është edhe Kombëtarja e Shqipërisë, e cila ndeshjen e parë e zhvillon të shtunën në mbrëmje ndaj Kombëtares së Italisë. Kuqezinjët janë optimist për një nisëm të mbarë, derisa bëjnë pjesë në grupin e “ferrit” së bashku me Spanjën dhe Kroacinë.

### GJERMANI-SKOCI, FORMACIONET E MUNDSHME:

GJERMANIA: Neuer; Kimmich, Tah, Rudiger, Mittelstadt; Kroos, Andrich; Musiala, Gundogan, Wirtz; Havertz.  
SKOCI: Gunn; Hendry, Hanley, Tierney; Ralston, McTominay, Gilmour, Robertson; McGinn, Christie; Shankland.

## Hyseni bën hapin e madh, nga KF Llapi kalon te AC Horsens

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Skuadra e Llapit ka njoftuar se ka arritur marrëveshje zyrtare për transferimin e futbollistit Muhamet Hyseni për pesë vite në klubin AC Horsens që bënë gara në divizionin e parë të futbollit danez. Marrëveshja me klubin AC Horsens është arritur në pajtueshmëri të plotë me futbollistin Hyseni, i cili do u bashkohet atyre në përgatitje para

datës 20 qershor. Llapi ka bërë me dije se ka negociuar tash e disa muaj me klubin AC Horsens për transferimin e Hysenit, teksa sot edhe është zyrtarizuar nga klubi danez. “AC Horsens kanë qenë ndër klubet më serioze dhe me projektin më të mirë si për futbollistin ashtu edhe për ne si klub, ku gjatë bisedimeve kemi rënë dakord që përveç Hysenit, klubet do bashkëpunojnë ngushtë edhe për futbollistë tjerë nga KF Llapi”, thuhet në njoftimin e klubit llapjan. Muhamet Hyseni në dy



periudha kohore me Llapin, ka zhvilluar në total 80 paraqitje, 33 gola e 11 asistime. Në sezonin që sa po përfundoi Hyseni u shpall golashënuesi më i mirë i Albi Mall

Superligës me 26 gola të realizuar. Krahas 26 golave, ai kontribuoi edhe me 6 asistime, duke ndihmuar klubin të kualifikohet në raundin e parë të Ligës së Evropës si nënkampion. “Klubi do e ndjej boshllëkun e lënë nga ai para ndeshjeve shumë të rëndësishme evropiane, megjithatë insistimi i vazhdueshëm i klubit AC Horsens, ka bërë që Hyseni përkundër dëshirës së madhe për të kontribuar edhe më tej për Llapin, t’i bashkëngjitët klubit të ri.

KF Llapi falënderon përzemërsisht futbollistin Muhamet Hyseni për kontributin e çmueshëm për klubin, golat dhe asistimet. Një futbollist si Hyseni do mbahet gjatë në mendjet e secilit tifoz llapjan. Pa dyshim që si futbollist, karriera e tij do të jetë shumë e ndritshme, megjithatë në çdo kohë, dyert e KF Llapit do të jenë të hapura për futbollist me karakter dhe profesionist si ai. Faleminderit kampioni ynë, Muhamet Hyseni”, thuhet ndër të tjera në njoftimin e Llapit.

## Komuna e Pejës dhe “FC Besa Peja”, nënshkruajnë marrëveshje për shfrytëzim të hapësirave sportive

Pejë, 13 qershor - Komuna e Pejës ka njoftuar për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me FC “Besa Peja”, për shfrytëzimin e hapësirave sportive në Sigë të Brestovikut, të cilat u nënshkruan nga kryetari Gazmend Muhaxheri dhe

drejtorit sportiv të klubit, Arben Muqolli. Komuna e Pejës e ka cilësuar këtë marrëveshje të rëndësishme, pasi qëllimi i saj sipas tyre është të definojë përgjegjësitë e palëve për shfrytëzimin objektit sportiv në Sigë – Brestovik. “Kjo marrëveshje

ka për qëllim të definojë në mënyrë të qartë dhe specifike përgjegjësitë e palëve për shfrytëzimin e drejtë dhe profesional të objektit sportiv në Sigë – Brestovik”, thuhet në njoftimin e komunës së Pejës. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje u

bë në arenën sportive “Tahir Vokshi”, në fshatin Brestovik të Pejës, ku ishin të pranishëm edhe disa zyrtarë komunalë dhe pjesëtarë të klubit “FC Besa Pejë”. Ndryshe, Besa do ta nis sezonin nga ligat e ulëta me synim ngjitjen në Superligë pas disa vitesh.





## Ramadani: Italia? Luajmë për fitore

DORTMUND, 13 QERSHOR - Ylber Ramadani, mesfushori kuqezi, pjesë e Lecces në Serie A, në një intervistë për "Sky", foli për sfidën e parë në "Euro2024", atë kundër Italisë. "Në Itali ka shumë shqiptarë, jemi shumë të lumtur që përfaqësojmë tifozët tanë në këtë Evropian.

Italia? Ne zbresim në fushë vetëm për të fituar, gjithmonë. Mister Sylvinho ka ndërtuar një grup të madh, jemi shumë të bashkuar. Kemi bërë një fazë kualifikuese fantastike, shpresojmë shumë që ta përsërisim edhe në Evropian, u shpreh Ramadani. "Ne i

njohim shumë mirë lojtarët e Italisë, ne do të bëjmë gjithçka për të marrë atë rezultat që dëshirojmë. E ardhmja? Më mirë të mos flas, pasi më merr drejtori në telefon. Jam totalisht i përqendruar tek Evropiani, të shohim më pas në përfundim të Evropianit", ka

shtuar Ramadani, i cili në fund bëri edhe një koment për Armando Broja: "A më ka kërkuar këshilla mbi Italinë? Jo, ne jemi të përqendruar vetëm tek Evropiani. Broja është një lojtar i fortë që mund të luajë në çdo skuadër në botë, ka një potencial shkatërrues".



## Asllani: Synojmë rezultat të madh ndaj Italisë

DORTMUND, 13 QERSHOR - Kombëtarja e Shqipërisë mbylli me sukses fazën përgatitore në Austri dhe tani "Kuqezinjtë" janë vendosur në Kaiserau në Kamen ku do të qëndrojnë dhe përgatiten në kuadër të finaleve të Evropianit "Gjermani 2024", më konkretisht për sfidat ndaj Italisë, më 15 qershor, Kroacisë, më 19 qershor dhe Spanjës, më 24 qershor. Siç e do zakoni, nga kampi bazë në SportCentrum Kaiserau po zhvillohet edhe konferenca e radhës për shtyp, ku mesditën e kësaj të enjteje fjalën e mori "arkitekti" i mesfushës së legjionarëve, Kristjan Asllani, i cili më tej gjatë konferencës foli edhe nivelin e lartë në mesfushë që Italia zotëron, si edhe për mbështetjen e zjarrtë të "Tifozëve Kuq e Zi", që pret gjatë Evropianit. "Përgatitje deri më tani kanë shumë mirë. Ka shumë harmoni dhe shumë pozitivitet brenda grupit. Të gjithë jemi të fokusuar te ndeshja, ndaj Italisë, jemi duke analizuar gjatë gjithë kohës kundërshtarin, po shohim video të tyre duke luajtur dhe tanimë na mbetet veçse të presim. Mungesa e Barella nuk ndikon, pavarësisht se ky është një nga lojtarët më të mirë në botë. Italia ka një mesfushë shumë të fortë, në qoftë



se nuk është Barella është Frattesi, edhe ky një lojtar shumë i aftë në fushën e blerit. Do të provojmë të arrijmë një rezultat të madh, por sigurisht nuk është e lehtë. Unë besoj se forca jonë është grupi, si dhe tifozët që na kanë mbështetur si gjithmonë dhe po i presim sa më shumë sepse janë të zjarrtë", ka thënë Asllani. "Emrat përfundimtarë i vendos trajneri, por besoj do t'i përmbahemi kualifikuesve, megjithatë nuk është vendosur asgjë akoma. Unë mund të luaj në çdo modul, si në

4-3-3, si në 4-2-3-1, pasi kjo nuk ndryshon gjë. Në fushë duhet grintë. Në fushë dua si kundërshtarë të gjithë shokët e mi, tek Inter, pasi kanë luajtur fort përgjatë gjithë sezonit me mua dhe janë të gjithë shumë profesionistë dhe dua t'i shoh në fushë kundra meje. Besoj se Armando (Broja) mund t'i bëjë goxha dëm, jo vetëm Italisë, por çdo skuadër, pasi është një lojtar shumë i shpejtë, teknik dhe i fortë, dhe shpresoj që të bëjë ndonjë gol", ka shtuar Asllani.

## Bostoni tjetër leksion Dallasit, një fitore larg titullit në NBA

Dallas, 13 qershor - Boston Celtics është një fitore larg titullit kampion në NBA për sezonin sportiv 2023-2024. Ekipi kampion i Lindjes fitoi së fundmi me rezultat 106-99 në fushën e Dallas Mavericks në finalen e tretë "play-off", duke udhëhequr 3-0 serinë e takimeve dhe mund të ngrenë trofeun e kampionit që në sfidën e radhës. Një ndeshje në përgjithësi e ekuilibruar, ku pjesa e parë u mbyll 51-50 për vendasit. Në çerekun e tretë, Bostoni shkëputet deri në 15



pikë, por nuk arrin dot ta mbyllë ndeshjen. Dallasi ngushton deri në 1 pikë diferencën (93-92), por pa mundur dot të bëjnë përmbyshjen e madhe. Celtics

shkëputet sërish në periodën e fundit dhe fiton me meritë. Tatum me 31 pikë e Brown me 30 pikë ishin dy liderët e skuadrës së Bostonit në këtë ndeshje. Për Dallasin "zgjohet" Irving, që realizoi 35 pikë, ndërsa Donçiq shënoi 27 pikë, por që s'mjaftuan për të fituar ndeshjen. Edhe sfida e radhës do të luhet në fushën e Dallasit, që do të synojë fitoren, si mundësia e vetme për të rihapur garën për titull, ndërsa fitorja e Bostonit e shpall automatikisht kampion.

### SHKURT

#### Ballkani konfirmon largimin e Ismajlgecit

Pas Armend Thaqit, Edvin Kuç, Lorenc Trashit, Mamadou Danfas, Nazmi Gripshit nga klubi kampion i Kosovës në futboll është larguar edhe futbollisti Marsel Ismajlgeci. Ky i fundit ishte i huazuar në klubin nga Suhareka dhe ky huazim tashme ka përfunduar. "Marrëveshja e huazimit të Marsel Ismajlgecit me FC Ballkanin ka përfunduar. Klubi e falënderon futbollistin për kontributin e dhënë në skuadrën tonë, duke i dëshiruar suksese në vazhdimin e karrierës së tij. Paç fat Marsel!", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

#### Verstappen: Pas meje Leclerc dhe Norris do të jenë kampionë bote

Kampionët mund të njihen menjëherë. Sidomos në Formula 1, ku pilotët i njohin përmendsh pikat e forta dhe të dobëta të rivalëve të tyre, në shumë raste duke garuar me ta që nga ditët e kartingut. Max Verstappen, por tre herë kampioni i botës e di mirë se si ky sport mund të japë aq sa mund të heqë, pavarësisht nga cilësitë e tua të drejtimit. Prandaj ai e di se pas tij ka pilotë që meritojnë një titull, si Charles Leclerc dhe Lando Norris. Për "DAZN", piloti holandez ka thënë: "Vë bast një darkë se Charles dhe Lando do të bëhen kampion bote në të ardhmen. I pari do të jetë Leclerc, por edhe Norris e meriton". Në fakt, ka shumë pilotë për t'u përmendur. Ky vit ka sjellë shumë rivalitet në Formula 1 dhe Norris (McLaren) e Leclerc (Ferrari) janë ata që kanë fituar këtë vit (bashkë me Carlos Sainz). Ndaj dhe Verstappen mendon se ata do të arrijnë ta mposhtin një ditë.

#### Rice: Duam të bëjmë histori në Gjermani

Mesfushori i Arsenalit, Declan Rice beson se Anglia mund të shkruajë historinë në "Euro 2024". Anglia është ndër favoritët për të fituar "kurorën" kontinentale, tre vjet pas humbjes dramatike në finalen e "Wembley" me penallti kundër Italisë. "Ne duam të bëjmë histori. Ne e themi këtë gjatë gjithë kohës, por me të vërtetë kemi një grup, një menaxher, që beson vërtet. Ne kemi besim se mund të shkojmë atje dhe të bëjmë diçka vërtet të veçantë dhe, sigurisht, me këtë vjen puna e vështirë. Kjo do të jetë gjëja kryesore: puna e palodhur si ekip, uniteti, bashkimi dhe me këdo në mbështetjen tonë nga shtëpia. Ne do ta ndiejmë këtë me siguri, kështu që qëndroni me ne, jini pozitivë dhe le të shohim se çfarë do të ndodhë. Nuk mund ta marrësh si të mirëqenë. Jemi gati të shkojmë dhe të luajmë një turne për vendin tonë. Është një privilegj, një nder dhe ndihet shumë reale tani. Kur fillon të bësh gjëra të tilla, fillon të ndihet e vërtetë", ka thënë Rice.

## Paulo Fonseca edhe zyrtarisht trajner i Milanit

AC Milan ka njoftuar se Paulo Fonseca është emëruar trajner i ekipit. I lindur në Nampula (Mozambik) më 5 mars 1973, Paulo Fonseca filloi karrierën e tij si trajner në vitin 2005 në sistemin e të rinjve të Estrela da Amadora

përpara se të merrte pozicione në nivelet e ulëta të futbollit profesionist portugez. Ai bëri paraqitjen e tij të parë në një ndeshje të parë me Paços de Ferreira, me të cilin u kualifikua në raundin e "play-off"-it të Ligës së

Kampionëve. Ai u bashkua Portos në vitin 2013 dhe fitoi Supertaça, titulli i tij i parë si trajner. Pas një magjie te Braga, të cilën e udhëhoqi drejt një titulli Taça de Portugal, ai u bashkua Shakhtar Donetsk ku fitoi shtatë trofe dhe përfundoi me

një rekord prej 103 fitoresh në 139 ndeshje. Në vitin 2019, ai bëri paraqitjen e tij të parë në futbollin italian kur u transferua te AS Roma, me të cilin arriti në gjysmëfinalen e Ligës së Evropës në vitin 2021. Trajneri kryesor i LOSC që nga vera

e vitit 2022, Fonseca ka përfunduar detyrën e tij në Francë pas dy sezone, në të cilat ai dy herë kontriboi në kualifikimin e Lille në garat evropiane. Trajneri portugez tani i bashkohet AC Milan me një kontratë trevjeçare.



INTERVISTË ME PRESIDENTIN E FC KOSOVA DÜSSELDORF, BUJAR NEZIRIN

# Neziri: FC Kosova Düsseldorf synon ngritjen në Oberliga

Qëllimi i FC Kosova Düsseldorf, ngritja në një ligë më lartë në Gjermani dhe fitorja e Superkupës Kosovë-Diasporë ndaj Ballkanit

**EPOKA E RE** Intervistoi: Sadik ZEQRIRI

DUSSELDORF, 13 QERSHOR - FC Kosova Düsseldorf e themeluar në vitin 1989, nga sezoni 2024/25 luan në ligën gjermane Landesliga. Pas një paraqitje spektakolare të lojtarëve dhe një organizimi të pashoq të mërgatës në këtë qytet të bukur të Gjermanisë, FC Kosova Düsseldorf, është ngritë nga Bezerskliga në një rang më lartë. Sukseset e klubit përpos që erdhën si rezultat i paraqitjes së mirë të lojtarëve edhe angazhimi i pakompromis i kryesisë së klubit në krye me presidentin Bujar Neziri dhe të tjerët të cilët nuk kanë kursyer asgjë, duke dhënë maksimumin për klubin me të vetmin qëllim, që t'i mbajnë afër shqiptarët, por dhe të valojë flamuri shqiptar në këtë republikë gjermane. Këto suksese kanë bërë që klubi i shqiptarëve të merr respektin e të gjithë qytetarëve pa dalim kombi. Ky klub është themeluar në vitin 1989, atëherë edhe kur është suprimuar Autonomia e Kosovës, e që një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës, iu kanë bashkuar mërgatës në këtë qytet, por dhe në qytete tjera në Perëndim. Dhe pikërisht ishte mërgata ajo që themeloi klubin, duke i angazhuar lojtarët e asaj kohe për të dhënë kontributin e tyre fizik, ndërsa duke i mbështetur financiarisht shqiptarët të cilët ishin më herët në këtë qytet. Vlen të ceket se në këtë klub në filllet e para kanë luajtur Nadir Haxhimusa, Naim Sojeva, Muharrem Sahiti, presidenti i tanishëm Bujar Neziri, e shumë e shumë tjerë. Si themelues të klubit dhe mbështetës të pakursyer ishin dhe janë Gani Nuha, Naim Konjufca, Enver Shala, Besim Musa, Ekrem Berisha, e shumë tjerë. Njëri ndër ta Gani Nuha, ka munguar fizikisht gjatë periudhës 1998-1999, për arsye se ai iu është bashkuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe ka qenë njëri ndër luftëtarët që ka kontribuar shumë për lirinë e Kosovës. Pas përfundimit të luftës Ganiu është rikthyer prapë në Gjermani për të vazhduar jetën aty ku e kishte lënë dhe për ta mbështetur edhe komunitetin shqiptar si dhe klubin e zezrës FC Kosova Düsseldorf. Për tu njoftuar me shumë rreth klubit dhe sukseseve të saj, ekipi i gazetës "Epoka e re", ka qëndruar në Gjermani dhe ka



pa nga afër situatën e klubit, si dhe ka zhvilluar një intervistë me Presidentin e Klubit, Bujar Nezirin, një humanist dhe sportdashës i cili njëkohësisht së bashku me shumë tjerë është edhe sponsorisues i këtij klubi por edhe qytetar që merr pjesë në shumë aksione humanitare, aty ku e kërkon nevoja dhe koha.

**"Epoka e re":** z. Neziri ju jeni president i klubit FC Kosova Düsseldorf, dhe në këtë vit jeni ngritur për një ligë më lartë, që do të thotë se në sezonin 2024/25 ju do të paraqiteni në Landesliga. Cili është qëllimi i klubit gjatë kësaj sezone?

**Bujar Neziri:** Qëllimi ynë është të freskojmë klubin me disa prurje të reja që të stabilizohemi në mesin e

tabelës, por nëse na jepet mundësia të arrijmë edhe qëllimin tonë që të kalojmë edhe këtë ligë.

**"Epoka e re":** Klubi kishte filluar me disa ndryshime, a e keni pa të nevojshme të bëni këto ndryshime duke filluar nga trajneri e tutje?

**Bujar Neziri:** Po kemi marrë një trajner që është i nivelit tjetër, është maroken dhe e njëhë mirë Landesligën. Po ashtu kemi marrë edhe katër përforcime deri tani si dhe jemi në bisedime edhe me dy lojtarë tjerë. Fatkeqësisht kemi larguar disa lojtarë të cilët i falënderojmë për kontributin e tyre, por mundësitë financiare i kemi të vogla që t'i mbajmë, kështu që i kemi shkëputur kontratat me ta.

**"Epoka e re":** Z. Neziri, cili është klubi më i suksesshmi prej shqiptarëve në Gjermani?

**Bujar Neziri:** Unë mendoj që klubi më i suksesshmi ndër shqiptar dhe më i trofeshmi është FC Kosova Düsseldorf. Është edhe Kosova Rengensburg një klub shumë i mirë, mirëpo ajo është në rangun e 7, ndërsa ne jemi në rangun e 6-shtë në ligën gjermane. Jemi edhe me organizim më së miri, sepse i qëndrojmë klubit afër me financa, por dhe me mbështetje morale. Unë vet kam luajtur në këtë klub prej themelimit deri në vitin 2001. Në këtë klub kanë luajtur edhe lojtarët e ligës së parë të Kosovës dhe të ligës së dytë të cilët kanë ardhur për të jetuar në Gjermani si Nadir Haxhimusa, Naim Sojeva,

Shaban Maloku, Rexhep Murseli, Muharrem Sahiti, Ismet Haliti etj. Pra deri më tani i kemi kaluar katër liga për të ardhur në këtë ligë ku jemi. Në këtë qytet është Fortuna e Dyseldorfit prej ekipeve më të mëdha e cila garon në Ligën e Dytë të Gjermanisë ndërsa ekipi FC Kosova Düsseldorf, është prej ekipeve të këtij shteti e dyta si më e ranguara. Dhe është mirë për lexuesit tuaj të bëjmë me dije se ekipi ynë ka luajtur lojë miqësore me Fortuna Dyseldorf në vitin 1998 dhe të gjitha mjetet e tubuara i kemi dërguar për Kosovë.

**"Epoka e re":** Z. Neziri, për të mbijetuar një klub duhet të ketë një fond të madh financiar. Si po ia dilni në krye me të gjitha ato paga, për lojtarë, për trajnerë dhe për stafin tjetër teknik, për pagesën e fushës pasi që ju si klub nuk keni as fushë sportive. A ju ndihmon shteti gjerman apo ju dhe mërgata e vetëfinanconi klubin?

**Bujar Neziri:** Na i kemi 54 sponsorë dhe të gjithë e ndihmojnë klubin pa asnjë përfitim e interes. Në si kryesi këto para që i marrim asnjë cent nuk e shpenzojmë të sponsorëve, dhe si kryesi i heqim shpenzimet me buxhet tonin vetanak, ndërsa parat e sponsorëve i shpenzojmë për lojtarë, dhe për çdo gjë raportojmë para kryesisë dhe sponsorëve tanë. Me siguri që edhe suksesi ynë është serioziteti i kryesisë para lojtarëve dhe sponsorëve. Ne jemi munduar që mos ta kemi vetëm një, por të kemi shumë sponsorë e jo të mbetet klubi vetëm në një sponsor sepse edhe ne mund të kemi telashe gjatë udhëtimit biznesor dhe më pas rrezikohet klubi, kështu që kemi shumë sponsor dhe e ndajmë barrë mbi të gjithë.

**"Epoka e re":** Këtu në Diasporë keni edhe një Federatë të Futbollit të Diasporës, si i keni raportet me ta, a u vizitoni ndonjëherë?

**Bujar Neziri:** Po këtu në Diasporë kemi Federatën e Futbollit, por fatkeqësisht ajo federatë është kot, sepse nuk i ndihmon dhe nuk e viziton asnjë klub shqiptar në Gjermani. Në Gjermani kemi 46 ekipe shqiptare ndërsa në turnin për Kupën e Diasporës në Gjermani kanë marrë pjesë vetëm 6 ekipe, kjo do të thotë se ne mendojmë që kjo Federatë është e kotë këtu sepse nuk kemi mbështetje rreth organizimit të këtyre eventeve as financiare e as





organizative, por dhe asnjë kontakt përmes saj nuk e kemi as me Federatën e Kosovës e leje me organizatat sportive gjermane. Dhe çka është më e keqja se edhe kur luhen garat e fituesit të kupës së diasporës dhe asaj të Kosovës, në Kosovë, Federata nuk na i mbulon asnjë shpenzim, të këtij takimi dhe ne duhet si klube të kujdesemi edhe për akomodim edhe për udhëtim edhe për bileta, madje ne duhet edhe zyrtarëve të Federatës së Futbollit të Diasporës t'ia paguajmë biletat e udhëtimin, akomodimin dhe ushqimin, sikur të janë pjesë e klubit. E kjo është për turp të zotit. Për kontributin tonë për sensibilizimin e sportit të Kosovës në vitin 1997 me iniciativën time Reprerentacioni i Kosovës e ka luajt lojën e parë jashtë Kosovës



**“Epoka e re”:** President, duke i pa kapacitetet e lojtarëve të FC Kosova Düsseldorf, a ka ne mesin tuaj, ndonjë lojtar që është i gatshëm t'i bashkohet Përfaqësueses së Kosovës, pasi siç deklaruar edhe më herët se Landesliga gjermane është si e barabartë me Ligën e Parë të Kosovës?

**Bujar Neziri:** Shumë faleminderit për këtë pyetje. Nuk mund të them me përgjegjësi të plotë që kemi lojtar të përgatitur për reprezentacione të Kosovës, tani për tani. Pse e them këtë, sepse këtu ne klubin tonë kemi talente të jashtëzakonshëm, siç janë Astrit Hyseni pastaj Enis Vila por dhe tjerët, megjithatë këta lojtarë fatkeqësisht nuk e kanë përgatitjen fizike të mjaftueshme sepse këta këtu punojnë edhe



në Dyseldorf, dhe këtë e dinë mirë të gjithë dhe për këtë arsye ne si klub duhet të kemi vëmendjen edhe të FFK-së në Kosovë, sepse kontributi ynë është i jashtëzakonshëm në aspektin sportiv dhe human.

**“Epoka e re”:** Z. Neziri, klubi juaj është edhe fitues i Kupës së Diasporës, çka do të thotë kjo. Çka më tutje?

**Bujar Neziri:** Po ne jemi fitues të Kupës së Diasporës për vitin 2024, ne si klub kemi fituar edhe në vitin 2022 Kupën e Diasporës, ku jemi ndeshë me Llapin në Kosovë, ndërsa këtë vit në muajin tetor do të ndeshemi me fituesin e Kupës së Kosovës, Ballkanin e Suharekës. Por ditë me parë kemi marrë një njoftim se një herë do të luhet edhe një ndeshje në mes fituesit të Kupës në Gjermani dhe fituesit të Kupës në Zvicër, dihet të klubeve shqiptare, dhe fituesi i këtij takimi atëherë do të përballet me Ballkanin e Suharekës, e ku mund të them me përgjegjësi të plotë se ne do të fitojmë ndeshjen kundër shqiptarëve të Zvicrës, pastaj për të fituar edhe kundër Ballkanin. Edhe pse dihet që klubi i Ballkanik ka një organizimi të mirë, është e

fortë financiarisht, ka lojtarë të talentuar, ka lojtarë që mbrojnë ngjyrat e Reprerentacionit të Kosovës, luan në garat evropiane por ne atje do të shkojmë për të fituar. Lojtarët e FC Kosova

Düsseldorf, futbollin e kanë si punë të dytë, pasi që ata të gjithë janë të angazhuar edhe në punë dhe ushtrojnë pas orarit të punës, ndërsa lojtarët e Ballkanit, ushtrojnë pesë herë në javë dhe

janë të përgatitur më mirë se ne, po ashtu lojtarët e Ballkanit kanë paga më të mira se lojtarët tonë, por megjithatë ne shkojmë në Kosovë për të treguar aftësitë tona dhe për të fituar nëse mundemi.

punë tjera dhe kjo është arsyeja. Po të kishin vetëm futbollin primar, atëherë këta do të kishin qenë të pazëvendësueshëm në Reprerentacionin e Kosovës. Ne në klub moshën mesatare e kemi 24-vjeç të lojtarëve dhe kjo është shpresëdhënëse që do të arrijmë suksese që të ngritët në OberLiga e ku atëherë do të jemi gjysmë profesional dhe mendoj se do të jemi një furnizues i vogël për përfaqësuesen e Kosovës. Siç e thash edhe më lartë, ne shteti këtu në Gjermani nuk na ndihmon fare, dhe ne vet me kontributin tonë me sponsor, paguajmë fushën ku luajmë si vendas e ku lojtarët tanë ushtrojnë, pastaj kur të udhëtojmë po ashtu udhëtimet i mbulojmë vet e kështu me radhë.

**“Epoka e re”:** President pasi nuk keni fushë tuajën të klubit, a keni menduar që të blini një hapësirë apo edhe stadium të gatshëm?

**Bujar Neziri:** Po ne e kemi një stadium këtu që e paguajmë qiranë për ta shfrytëzuar, por njëherë përnjëherë duhet të kemi një burgjet të madh për të hyrë në këto investime. Si kryesi kemi menduar që të fillojmë më





grupmosha të reja që të punojmë dhe që të ngrihemi në nivelin profesional si klub e me pas në bazë të mundësive të ngjitemi në nivel tjetër organizativ. Në si klub kemi shumë shikues sepse në çdo lojë që luajmë kemi shikueshmëri të madhe deri në tremijë shqiptarë vijnë e na përcjellin. Bile na thonë skuadrat tjera gjermane dhe të nacionaliteteve tjera se kur është gjiroja që luajnë kundër ekipit tonë edhe ekipet kundërshtare gëzohen sepse tribunat e tyre mbushen me shikues. Ne si ekip kemi shikueshmërinë më të zjarrtë në këto liga.

**“Epoka e re”:** President Neziri, qytetarët të njohin jo vetëm si sportdashës dhe drejtues i klubit FC Kosova Düsseldorf, por edhe si një humanist i madh. Çka mund të na thuash më shumë?

**Bujar Neziri:** Po faleminderit për ata që më vlerësojnë kështu, unë përpos sportit si aktiv, unë kam edhe një biznes timin, dhe jam aktiv edhe në organizime humanitare duke kontribuar edhe vet. Të them të drejtën unë kam edhe në familjen time persona me aftësi të kufizuar dhe jam shumë i kujdesshëm për këtë shtresë të shoqërisë. Unë isha një ditë në vendlindje në Kosovë dhe aty në një bisedë e sipër me disa shokë na lindi ideja që të ndihmojmë Shoqatën e Hendikosit në Ferizaj. Pasi që në Komunën e Ferizajt janë mbi 1 000 persona me aftësi të kufizuar dhe që nuk kanë objekt se ku mund të kalojnë kohën e lirë, atëherë kemi formuar një Këshill Iniciues dhe kërkuam nga Komuna e Ferizajt që të na ndajë një parcelë për ta ndërtuar një objekt për nevoja të Hendikosit. Komuna na dha parcelën dhe në menjëherë organizuam një darkë humanitare me biznesmen edhe të Kosovës edhe të diasporës e ku mblodhëm një shumë të konsiderueshme të të hollave, mbi 200 mijë euro. Pastaj para dy muajsh deputeti Elmi Reçica organizoi një takim në Ferizaj që e quajtëm “kafja e bamirësisë” dhe aty kemi tubuar rreth 180 mijë euro duke kontribuar të gjithë me aq sa kishin mundësi. Deri më tani i kemi mbledhur 400 mijë euro, ndërsa na duhet edhe rreth 200 mijë euro për ta përfunduar objektin në tërësi me pajisje të nevojshme dhe kushte elementare që i nevojitet një personi të hendikepuar. Dhe për këtë arsye këto ditë kemi organizuar edhe një koncert humanitar që bashkatdhetarët të na bashkohen në ndihmë të ndërtimit të objektit të Hendikosit, në Ferizaj. Dua tua bëjë me dije se nuk do të thotë që këtu do të ndalemi, por do të vazhdojmë të kontribuojmë dhe të mbështetim çdo iniciativë nëpër të gjitha komunat e Kosovës, që tu ndërtojmë objektet e tyre Hendikosit.







## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Zyrtar/e i/e Lartë Ligjor
<b>Grada e pozitës:</b>	pesë (5)
<b>Kohëzgjatja e punësimit:</b>	me afat të pacaktuar
<b>Departamenti:</b>	Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit
<b>Raporton tek:</b>	Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit

### Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësi:

- Në bashkëpunim me udhëheqësit e njëjësive organizative të BQK-së përgatit konkurset për vende të lira pune.
- Monitoron afatet e vendimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit lidhur me emërimet me afat dhe përgatit plotësimin e vendimeve.
- Ofron shërbimet e sekretarisë së komisionit disiplinor dhe komisionit të ankesave të BQK-së.
- Drafton, rishikon dokumentet dhe aktet e departamentit të burimeve njerëzore dhe zhvillimit duke përfshirë propozimin e politikave dhe rekomandimeve relevante të departamentit duke siguruar që ato të përputhen me ligjin dhe praktikën më të mira të punës.
- Ofron këshilla/opinione ligjore me kërkesë dhe brenda fushëveprimit të departamentit.
- Krijimi dhe ruajtja e dokumentacionit ligjor dhe administrative në përputhje me standardet dhe rregulloret e aplikueshme.
- Shqyrton kërkesat e paraqitura, identifikon rastet e tilla dhe jep rekomandime profesionale për veprime të mëtejme.
- Ndërmerr veprime ligjore brenda autorizimeve dhe përgjegjësi të deleguara.
- Ruan sekretin dhe informacionin në përputhje me aktet ligjore të Bankës.
- Informon mbikëqyrësin e vet mbi rezultatet e punëve në vazhdimësi dhe mbi vështirësitë e hasura në lidhje me to.
- Bashkëpunon me departamentet tjera për zgjidhjen e çështjeve të ndërlikuara ligjore që kanë të bëjnë me punën dhe punësimin.
- Kryen punë tjera administrative që kanë të bëjnë me personelin.
- Promovon barazinë dhe diversitetin si pjesë e kulturës në Bankë.
- Kryen detyra të tjera të caktuara sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

### Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë apo juridike - Fakulteti Juridik ose ekuivalent.
- Njohje e ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës me theks të veçantë në njohjen e Ligjit të Punës, Ligjit për Bankën Qendrore, dhe politikave të burimeve njerëzore.
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe.
- Njohja e gjuhës angleze përparësi.
- Njohje e aplikacioneve të MS-Office.

### Përvoja e kërkuar:

- Minimum 3 vite përvojë pune (të dëshmuara) profesionale në fushën juridike. Përvoja e kërkuara në fushën e burimeve njerëzore do të jetë përparësi.

### Kërkesat e posaçme:

- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe shkrim ligjor (formulim të shkresave rekomandimeve dhe opinioneve ligjore).
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi.
- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e çështjeve sipas prioriteteve.
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore.
- Përgjegjshmëri dhe integritet në menaxhimin e informacionit të ndjeshëm dhe të përshkallëzuar.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **28 qershor 2024**
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

<b>Naziv radnog mesta:</b>	Viši pravni službenik
<b>Stepen pozicije:</b>	pet (5)
<b>Trajanje radnog odnosa:</b>	na neodređeno vreme
<b>Odeljenje:</b>	za ljudske resurse i razvoj
<b>Izveštava:</b>	direktoru Odeljenja za ljudske resurse i razvoj

### Pregled dužnosti i odgovornosti:

- U saradnji sa rukovodiocima organizacionih jedinica CBK-a priprema konkurse za slobodna radna mesta.
- Prati rokove donošenja odluka Izvršnog odbora i guvernera u vezi sa imenovanjima u roku i priprema dopunu odluka.
- Pružna usluge sekretarijata disciplinske komisije i komisije za žalbe CBK-a.
- Izrađuje, pregleda dokumente i akte odeljenja za ljudske resurse i razvoj, uključujući predlaganje relevantnih politika i preporuka odeljenja kako bi se osiguralo da su u skladu sa zakonom i najboljom radnom praksom.
- Daje pravne savete/mišljenja na zahtjev i u okviru delokruga odeljenja.
- Izrada i vođenje pravne i administrativne dokumentacije u skladu sa važećim standardima i propisima.
- Razmatra podnesene zahteve, identifikuje takve slučajeve i daje stručne preporuke za dalje postupanje.
- Preduzima pravne radnje u okviru delegiranih ovlašćenja i odgovornosti.
- Čuva tajnost i informacije u skladu sa zakonskim aktima Banke.
- U kontinuitetu obaveštava svog pretpostavljenog o rezultatima rada i o poteškoćama u vezi s njima.
- Sarađuje sa drugim odeljenjima na rešavanju složenih pravnih pitanja vezanih za rad i zapošljavanje.
- Obavlja i druge administrativne poslove koji se odnose na osoblje.
- Promoviše jednakost i raznolikost kao deo kulture Banke.
- Obavlja i druge dodeljene poslove po zahtevu pretpostavljenog.

### Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma iz oblasti prava - Pravni fakultet ili ekvivalent.
- Poznavanje važećih zakona u Republici Kosovo sa posebnim naglaskom na poznavanje Zakona o radu, Zakona o Centralnoj banci i politike ljudskih resursa.
- Tečno govorenje i pisanje albanskog i/ili srpskog jezika.
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.
- Poznavanje MS-Office aplikacija.

### Potrebno iskustvo:

- Minimalno 3 godine (dokazanog) profesionalnog radnog iskustva u pravnoj oblasti. Potrebno iskustvo u oblasti ljudskih resursa predstavljace prednost.

### Posebni zahtevi:

- Istraživačke, analitičke, ocenjivačke veštine i veštine pravnog pisanja (formulisanje pisama preporuke i pravnih mišljenja).
- Pažnja prema detaljima, prema jasnim formulisanjima i tačnost.
- Veštine komunikacije u pisanju kao i sposobnost rešavanja problema prema prioritetima.
- Samoinicijativnost i spremnost za timski rad.
- Odgovornost i integritet u upravljanju osetljivim i eskaliranim informacijama.

### Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem je naglašen interes za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Kosovskog fonda penzione štednje (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

### Postupak prijave:

- Poslednji rok za podnošenje prijave je **28 jun 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali načini za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

## Thirrje për aplikim

**BELLINI A SHPK – Perfaqesuar nga Astrit Selimaj**, NUI: 811284273, me adresë Fshati Skivjan, Komuna e Gjakovës, po kërkon ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

**“Furnizim dhe pune: Furnizim dhe montim i komplet sistemit fotovoltaik per energji solare minimumi 80kW”**

**Nr. Prokurimit Bellini/AZHB 01-2024.**

Emri: **BELLINI A SHPK**

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: **astrit\_selimaj@hotmail.com**

Adresa: **Skivjan, Komuna e Gjakovës**

Tel: **044 100 251**

Ofertat duhen dorëzuar më së largu **15 dite nga dita e publikimit ne gazete, ora 16:00**, në zyrat e kompanisë Skivjan, Komuna e Gjakovës

# Lumë's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ambulanca Neuropsikiatrike “Mens Sana” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70933225.

- Miran Xhelili, shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës, me nr. KO-46627/A-05-20 Diploma: 0148/9 datë, 24.06.2013 Gjilan.

- Altin Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Florije Rama Molliq KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Bajram Sadriu” Berjah nga kl. 1-8.

- Qëndresa Gjokaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Tahir Asllani Brovin KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Mimoza Paloja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat kl. 10.11.12.13. të sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC** cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1909

**RC** cola  
Columbus, Georgia, USA  
0.5L



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

